



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në
“Infermieri”
i
Institucionit të arsimit të lartë “Universiteti Europian i
Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Vjollca Durro

Dr. Nevila Heta Alliu

Shtator/2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Për programin e studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave në "Infermieri"**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Infermieri"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 665 datë 12.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Pasi të akreditohet
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	S'ka
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite/ 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	<u>18-19</u> : 8 PAE/ 1 PAK <u>19-20</u> : 7 PAE/ 5 PAK <u>20-21</u> : 9 PAE/ 3 PAK
18	Numri i studentëve:	19
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës:


Universiteti Europian i Tiranës (UET) është institucion privat i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 636, datë 20.09.2006, si Shkolla e lartë universitare jo publike “Universiteti Europian i Tiranës” si dhe programe të studimit të ciklit të parë. Në vitin 2011 me VKM Nr. 657 datë 25.09.2011. Ky institucion është akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 246, datë 24.07.2009. Institucioni është riakredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 12 datë 7.04.2017 “Për akreditimin periodik të Universitetit Europian të Tiranës” me vlefshmeri akreditimi deri në vitin 2022.

UET përbëhet nga 5 njësi kryesore, Fakulteti i Inxhinierise, Informatikes dhe Arkitektures, Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike, Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marredhënieve Ndërkombëtare, Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale dhe Fakulteti i Ekonomise, Biznesit dhe Zhvillimit.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” zhvillohet në Fakultetin e Shkencave Mjekesore Teknike i cili është hapur me Urdhërin Nr. 530 date 04.09.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për hapjen e njësisë kryesore “Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike” në Universitetin Europian të Tiranës me tre programe studimi Bachelor në Infermieri, Fizioterapi dhe Imazheri.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike përbëhet nga tre departamente, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Departamenti i Imazherisë dhe Qendra e Kërkimeve Shkencore në Shëndetin Publik.

Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Infermieri” ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, në Fakultetin e Shkencave Mjekesore Teknike. Ky program studimi është hapur me UMASH Nr. 665, datë 12.10.2018 dhe ofrohet me 120 kredite (ECTS), kohëzgjatje 2 vite akademik, në gjuhën shqipe dhe kohë të plotë studimi. Në përfundim të studimeve lëshohet diplome “Master i Shkencave” në “Infermieri”.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm:

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit të programit të studimit Master i Shkencave në “Infermieri”, i ofruar nga UET. Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve të ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në “Infermieri”, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive. [ascal.al]

Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet njerëzore, financiare, infrastruktura, logjistika për realizimin e programit të studimit; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Procesi i vlerësimit është bazuar në Manualin e vlerësimit [ascal.al] të miratuar nga ASCAL/BA dhe në përputhje me afatet e përcaktuara nga ASCAL sipas agjendës së vlerësimit.

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjyqimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.

Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Prof. Dr. Vjollca Durro dhe Dr. Nevila Heta Alliu Koordinatorë Teknikë të ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Aviola Bardhi.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e UET.

GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.

Më datë 30/07/2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 19/55 Prot., datë 30/07/2021, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 13/08/2021 dhe me shkresë zyrtare Nr 78/31 Prot., datë 23.08.2021.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. **Lidhur me standartin 1.5 dhe II.1** GVJ pas rishikimit të tabelave mer në konsideratë komentin e UET dhe pasqyroi në raport ndryshimin. Referuar ligjit Nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar theksohet se titullari i lëndës është i kategorisë Profesor, GVJ i qëndron vlerësimit të pasqyruar në raport për këtë kriter.
2. **Lidhur me standartin II.3** GVJ mer në konsideratë komenti i UET dhe pasqyron në raport ndryshimin.
3. **Lidhur me standartin 4.1** GVJ nuk merr në konsideratë komentin e UET. Me kod pune individët nuk mund të punojnë me kohë të plotë në dy institucione njëkohësisht. Në bazë të kodit të punës individit i njihen 40 orë në javë dhe me orët jashtë orarit deri në 50 orë në javë. Praktikisht është e pamundur që mjekë të angazhuar minimalisht 8 orë në shërbim spitalor apo në institucione të tjera, të realizojnë njëkohësisht dhe detyrimet akademike, administrative, mësimdhënëse dhe të kërkimit shkencor në një Institucion të arsimit të lartë.
4. **Lidhur me standartin 4.6** pas vënies në dispozicion nga ana e Institucionit të tabelave financiare dhe shqyrtimit të tyre, GVJ merr pjesërisht në konsideratë komentin e UET dhe pasqyroi në raport ndryshimin. **Gjithashtu GVJ ndryshon vlerësimin e këtij standarti.**
5. **Lidhur V.5.** GVJ i qëndron vlerësimin të saj në lidhje rekomandimin për rritjen e angazhimit të studenteve të këtij programi studimi në proceset vendim marrëse.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Infermieri”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER I SHKENCAVE”/“MASTER I ARTEVE”

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti Europian i Tiranës (UET) është institucion privat i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 636, datë 20.09.2006, dhe riakredituar për herë të fundit me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 12 datë 7.04.2017 “Për akreditimin periodik të IAL Universiteti Europian i Tiranës për një afat 5 vjeçar deri në vitin 2022. Programet që ofron nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe janë në përputhje me profilin e institucionit me qëllim ofrimin e arsimit cilësor dhe me standarte europiane. [takimi me dekanin].
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programet e studimit të ofruara nga UET synojnë përgatitjen e profesionistëve në fushat respektive dhe janë në përputhje me misionin dhe prioritetet strategjike të UET për të shërbyer zhvillimit social, kulturor dhe ekonomik të shoqërisë shiptare si dhe përparimit të arsimit të lartë dhe kërkimor shkencor në nivel kombëtar. UET e ka fokusuar veprimtarinë e vet në disa drejtime si shkenca ekonomike, juridike, politike, marrëdhënie ndërkombëtare, arteve liberale, shkencave humane, shkencave mjekësore dhe në këtë kuadër në këto drejtime studimi janë edhe programet studimit [statusi dhe rregullorja e UET]
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Gjatë takimit me drejtuesit e FSHMT dhe programeve, hartimi i programeve të studimit të ofruara nga UET bazohen zhvillimin ekonomik dhe strategjik të vendit, në studime të kryera nga institucioni lidhur me nevojat e tregut të punës për infermier të specializuar (të cilat janë në ritjefenomen që doli më shumë në pah gjatë pandemisë COVID -19), në takime me drejtues të urdhrave profesionistë në mjekësi, drejtues të institucioneve shëndetësore publike dhe jo publike, panairin e punës ku institucione të ndryshme shëndetësore, firmat farmaceutike, spitalet apo OJF-të paraqesin mundësitë e tyre për të punësuar studentë të programeve master në infermieri. Referuar strategjisë së zhvillimit të UET dhe strategjisë së programit të studimit, ky program studimi është në të njëjtin linjë me zhvillimet social-ekonomike të vendit, shërbimit shëndetësor dhe politikave lokale apo rajonale dhe synon të kontribuoj në plotësimin e

	nevojave për infermierë në tregun e punës dhe zhvillimin ekonomik kombëtar[strategjia UET & programit të studimit, studimi per tregun e punës].			
Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	Prorami i studimit Msc “Infermieri” ju shërben studentëve për thellimin e dijeve bazë, përfitim të aftësisve dhe kompetencave profesionale në fushën e manxhimit në kujdesit shëndetësor, orientimin e tyre në fushën e studimit dhe kërkimit shkencor. Njohuritë e mara në këtë program shërbejnë si bazë për vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë të doktoraturës apo përfshirjen e tyre në aktivitetin mësimdhënës[takimi me stafin drejtues, program studimit].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Institucioni ka hartuar planin strategjik të zhvillimit të institucionit për vitet 2021-2025 dhe strategjinë e zhvillimit të programit të studimit Master i Shkencave (MSH) në infermieri, në të cilën janë përcaktuar qartë drejtimet strategjike të zhvillimit të programit dhe fushat e studimit dhe kërkimit të cilat të janë në përputhje me objektivat strategjike të zhvillimit të UET, Fakultetit të Shkencave Mjeksësore Teknike dhe departamentit të infermieristikës dhe fizioterapisë ku zhvillohet ky program studimi.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjeksore Teknike ku realizohet ky program studimifunksion në bazë të Rregullores së UET miratuar nga rektori i UET në mars 2019 si dhe rregulloret e programeve të studimit që zhvillohen pranë fakultetit, rregulloreve në bazë të të cilave realizohet procesi akademik dhe kërkimomor shkencor. [rregullorja e UET, programit të studimit, njsbc, sekretarisë, burimeve njerëzore, rregullorja e provimit etj].</p>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Aktiviteti akademik i UET bazohet në Statutin e UET të miratuar me Urdhër Nr.90, datë 28.02.2017, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, plani strategjik të zhvillimit të UET 2021-2025, Strategjia e kërkimit shkencor 2021-2025, Rregullorene përgjithshme UET të miratuar në mars 2019 nga rektori i UET, Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit. Gjithashtu UET ka hartuar edhe rregulloret e organizimit dhe funksionimit të njësive bazë, programeve të studimit si dhe strukturave të tjerambështetëse. GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion konstaton se këto akte rregullatore janë sipas formatit zyrtarë. [takimi drejtuesit, rregulloret, statusi UET, plani strategjik UET 2021-2025, plani strategjik i kërkimit

	shkencor 2021-2025, rregullorja e njësisë bazë, programit të studimit, njsbc, sekretarisë, burimeve njerëzore].			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohet në përputhje me fushat e drejtimit akademik të institucionit [Statusi UET-së, Rregullorja UET-së, Strategjia e Kërkimit Shkencor së UET, strategjia e programit të studimit].			
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit	Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me fushën e veprimtarisë akademike të UET dhe strategjinë e kërkimit shkencor të UET 2021-2025, që përputhen me interesat kombëtar dhe trendeve e zhvillimit kombëtar dhe global si dhe plotësimit të nevojave të tregut të punës vëndas dhe ndërkombëtar për infermier të specializuar të cilët u evidentuan më qartë dhe gjatë pandemisë botërore të COVID 19[Strategjia e Kërkimit Shkencor së UET, strategjia e programit të studimit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Programi i studimit mastër shkencor në Infermieri paraqet në mënyrë përmbledhëse objektivat, mënyrën e organizimit dhe realizimit të tij duke respektuar lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe studentëve. Bazuar në këto objektiva, programi i ciklit të dytë MSH në Infermieri synon të përgatisë profesionistë të specializuar në fushat e infermieristikës, aftësimin e tyre për kërkim të avancuar të pavarur shkencorë, për zhvillim karrieredhe krijimin e bazës për vazhdimin e studimeve të doktoratës, të zhvillojnë aftësitë profesionale dhe kompetencat lidhur me evidentimin dhe zgjidhjen e problemeve shëndetësore në fushat të veçanta, drejtimin, komunikimit etik me pacientit dhe kolegët të aftë për tu përshtatur me tregun e punës si në sektorin shëndetësor publik dhe jo publik[rregullorja programit, kurikula, plani strategjik i zhvillimit të programit].
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për	Gjatë vizitës në institucion, GVJ identifikoi se institucioni akademik dhe drejtuesit, marrin informacione për nevojat e tregut të punës në mënyra të ndryshme si nëpërmjet studimit të tregut të punës, panairit të punës,

<p>programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>takimeve të zhvilluara më pedagogë, drejtuesit e urdherit të infermierit apo drejtues të institucioneve shëndetësore dhe Ministrisë së Shëndetësisë (që përbëjnë bordin e tregut të punës në rang fakulteti). Në organizimin e programeve të studimit dhe të planeve mësimore, për t'iu përgjigjur në kohë kërkesave të tregut të punës institucioni konsultohet me Bordin e Tregut të Punës në nivel Fakulteti [takimi me drejtuesit dhe stafin akademik].</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ka organizuar takime me Bordin e Tregut të Punës, Ditën e hapur e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike për vitet 2019,2020, duke i krijuar mundësi studentëve të kontaktojnë me biznese apo kompani që operojnë në fushën e shëndetësisë dhe të informohen lidhur me nevojat dhe mundësitë e tyre për staf infermior si dhe mundësitë e punësimit të tyre në këto struktura. FSHMT nuk ka ende të dhëna mbi punësimin e studentëve të diplomuar pasi është viti i parë i diplomimit të studentëve në këtë program studimi, porsa krijuar infrastrukturën e nevojshme për këtë qëllim. [Dokumenti 29 të dhënat për punësimin e studentëve, dokumneti i formularit B.16].</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Kurikula dhe përmbajtja e Programi i studimit krijojnë mundësi studentit për thellimin e dijeve bazë të marrë gjatë ciklit të parë të studimeve.</p> <p>Niveli i dijeve të ofruara në programet e lëndëve është i përshtatshëm për nivelin e ciklit të dytë të studimeve dhe ofron njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike për aftësimin dhe zhvillimin e kompetencës profesionale të studentëve si infermier të specializuar për tu përshtatur kërkesave të tregut të punës jo vetëm brenda vëndit po dhe jashtë tij si dhe orientimin e tyre drejt kërkimit shkencor [kurikula e programit].</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Për hartimin e programit të studimit institucioni është bazuar në programe të ngjashme të ofruara në vende të bashkimit europian si Itali dhe Gjermani. Në takimin me drejtuesit e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike dhe njësisë bazë u theksua se kurikula e programit është e ngjashme me programe të institucioneve të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare por nëndryshim nga këto të fundit kohëzgjatja e praktikës profesionale është më e shkurtër. Ngjashmëria në programet e studimit lehtëson punësimin dhe përshtatjen e studenteve në tregun ndërkombëtar të punës. Një ndihmesë në hartimin e programit të studimit Msc në Infermieri është përfshirja dhe mbështetje nga një projekt Erasmus+ me pjesmarje nga universitetet perëndimore të cilat mbështetën institucionin në hartimin e programit të ngjashme me modele të këtyre vendeve. [takimi me stafin drejtues, rregullorja, dokumenti të dhënat mbi projektet, shkëmbimet, publikimet dhe veprimtaria shkencore e stafit akademik].</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe</p>	<p>UET ka tashmë një eksperiencë disa vjeçare në fushën akademike në të tre nivelet e studimit dhe kërkimin shkencorë. Programi i studimit Msc në "Infermieri" është organizuar në përputhje me legjin e arsimit të</p>

<p>direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>lartëNr.80./2015 dhe përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, në lëndë dhe module të cilat vlerësohen me kredite ECTS. Programi Msc në “Infermieri” është me kohë të plotë studimi me zgjatje dy vite akademike, të organizuar në 4 semestër dhe ngarkesë vjetore për dy vite akademike 120ETC. Në kurikulën e programit shpërndarja e krediteve për të gjitha lëndët është sipas legjislacionit dhe ka lidhje midis lëndëve karakterizuese dhe atyre integruese.</p> <p>[takimi me stafin drejtues, statusi UET, plani strategjik I zhvillimit të programit, Plani mësimor dhe rregullorja e programit].</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Një nga komponentët më të rëndësishëm të programit është praktika profesionale. Bazuar në rregulloren dhe planin strategjik të zhvillimit të programit, prioritarë është aftësimi profesional i studentit dhe kërkimi shkencor. Ndërthurja e njohurive teorike me kryerjen e praktikës profesionale siguron formimin profesional për përshtatjen e tyre në tregun e punës. Praktika profesionale ju mundëson studentëve njohjen nga afër me detyrat që do të ketë infermieri, zgjidhjen e situatave të ndryshme gjatë menaxhimit të pacientit, komunikimin etik me pacientin dhe kolegët si dhe përfshirjen e tyre në kërkimin shkencor. Krahas praktikës profesionale në formimin profesional të studentit ndihmojnë dhe lëndët me karakteraplikues që ofron ky program studimi [kurikula e programit, plani mësimor].</p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit të institucionit.</p>	<p>Bazuar në vendimin e hapjes së këtij programi mësimor mësimdhënës zhvillohet në gjuhën shqipe. Në takimet në UET dhe RVB theksohet se institucioni mbështetur në statusin dhe “Planin strategjik të zhvillimit institucional” për ndërkombëtarizimin e institucionit ka marrëveshje bashkëpunimi në nivel institucional me institucionet arsimore dhe shëndetësore kombëtare dhe ndërkombëtare duke përfshirë dhe programet e studimit në FSHMT si marrëveshja me akademinë e edukimit dhe trainimit Gjermani, Austri, projekte të financuar nga fonde të bashkimit evropian me partner të huaj për ngritjen e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, projekt me universitetin Austri për shkëmbim të burimeve njerëzore dhe programeve, projekti Cordoba për shkëmbim studentëve/staf akademik në kuadër të programeve Erasmus plus, marrëveshje bashkëpunimi me Spitalin Universitarë të traumës, Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Spitalin Salus, Spitalin Amerikan, Qendrën kombëtare të Urgjencës Mjekësore” etj. [marrëveshjet dhe projekte të vënë në dispozicion të GVJ në faqen ascal].</p>
<p>Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>Institucioni ka një sistem të mirëorganizuar për ruatjen dhe arkivimin e gjithë dokumentacionin lidhur me organizimin dhe realizimin e programit mësimor, të dhënat e studentëve, stafit akademik, programin dhe planin mësimor në gjuhën shqipe.</p> <p>[vizita në institucion].</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Institucioni UET ka një eksperiencë disa vjeçare në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë (licensuar me VKM Nr. 636, datë 20.09.2006 dhe akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 12 datë 7.04.2017 “Për akreditimin periodik të IAL Universiteti Europian i Tiranës me kohëzgjatje normale 5 vite akademie). UET përbëhet nga 5 njësi kryesore, Fakulteti i Inxhinierise, Informatikes dhe Arkitekture, Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike, Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marredhënies Ndërkombëtare, Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale dhe Fakulteti i Ekonomise, Biznesit dhe Zhvillimit.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” zhvillohet në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike të hapur me Urdhërin Nr. 530, datë 04.09.2018 të MASH të përbërë nga 3 departamente në të cilat zhvillohen 7 programe studimi 3 programe bachelori, 3 programe studimi mastër shkencor dhe një program mastër profesional.</p> <p>Krahasuar me numrin aktual të studentëve të regjistruar dhe që ndjekin studimet, institucioni ka kapacitetet dhe burimet financiare që mundësojnë zhvillimin e programit të studimit për një numër më të madh studentësh, si dhe logjistikën <i>laboratorike dixhitale në 3 D nevojshme për zhvillimin e programit master në infermieri.</i></p> <p>Tashmë institucioni ka krijuar profilin e vetë në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon [vizita e ambienteve].</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve</p>	<p>Programi i studimit Msc në “Infermieri” zhvillohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe përputhet me fushën akademike dhe kërkimore të tij. FSHMT përbëhet nga tre departamente Departamenti i infermierisë dhe fizioterapisë, Departamenti i imazherisë dhe Qendra e kërkimeve shkencore në Shëndetin Publik. Në FSHMT sipas departamenteve zhvillohen 7 programe studimi is vijon:</p> <p>-Departamenti i fizioterapisë dhe infermierisë :</p> <p>a) Bachelor në "Fizioterapi"</p>

<p>kombëtare e evropiane.</p>	<p>b) Bachelor në "Infermieri" c) Mastër i shkencave në "Fizioterapi" d) Mastër i shkencave në "Infermieri" e) Master profesional në infermieri</p> <p>-Departamenti imazherisë</p> <p>f) Bachelor në "imazheri " g) Mastër i shkencave në "imazheri dhe radioterapi"</p> <p>Zhvillimi i procesit mësimor në FSHMT, si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi realizohet nga pedagogë efektive(PAE) dhe pedadgogë me kontratë (PAK) të cilët zotërojnë tituj akademik dhe grada shkencore.</p> <p>Profili i programit të studimit dhe fusha e përgjithshme dhe specifike e tij përputhet me atë të njësisë kryesore [rregullorja e FSHTM, rregullorja e programit të studimit, tabelat përmbledhëse]</p>								
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Programi i studimit Mastër iShkencave në Infermieri, ofrohet nga Departamentet e Departamentit i Fizioterapise dhe Infermierisë, fusha e veprimtarisë së të cilit përputhet me atë të programit të studimit. Programi i studimit është ndërtuar mbi bazën e Sistemit Europian të transferimit të krediteve ETC në përputhje të plotë me statusin e Universitetit dhe legjislacionin shqiptarë në fuqi. Programi i studimit zhvillohet në gjuhën shqipe dhe përfshin aktivitete mësimore në fushë menaxhim dheorganizmit në shëndet publik, metodat e kërkimit shkencor të avancuar dhe sasior, shkencat infermieristike sipas specialiteteve të cilat përputhen me interesat dhe nevojat kombëtare.</p> <p>[rregullorja dhe kurikula e programit të studimit].</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="571 1429 738 1507">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="738 1429 946 1507">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="946 1429 1153 1507">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1153 1429 1396 1507">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="571 1507 738 1563"></td> <td data-bbox="738 1507 946 1563"></td> <td data-bbox="946 1507 1153 1563"></td> <td data-bbox="1153 1507 1396 1563">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për</p>	<p>UET është një institucion që funksion në bazë të akteve rregullatore,</p>

<p>hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme punës së tyre.</p>	<p>bashkëpunimit dhe koordinimit brenda institucionit të stafit akademik, administrativë dhe stafit mbështetës. Aktet regullatore përcaktojnë organizimin, funksionimit, detyrimet dhe përgjegjësitë e stafit sipas pozicionit dhe funksioneve që kryejne në strukturat e universitetit, fakultetit apo programit të studimit ku ata janë të angazhuar. Disa anëtarë të personelit akademik mbulojnë pozicione të ndryshme në strukturën e institucionit ose angazhuar në komisione “ad hoc” të ngritura për tematika të ndryshme. Në mënyre periodike njësia kryesore, njësitet bazë, programet e studimit dhe njësitet mbështetëse si NJSBC, sekretaritet mësimore, këshillimi i karrierës, kryejnë analizën e aktivitetit të tyre, nxjerrin përfundimet dhe përcaktojnë masat që duhen të meren në zgjidhjen e problematikave të ndryshme apo përmirësimet e nevojshme. Në komunikimin e brendshëm midis stafit të institucionit një rol të rëndësishëm sistemi i komunikimit elektronik nëpërmjet se cilit realizohet shkëmbimi dhe përditësimi i informacionit, ndarja e punës etj. Sikundër u theksua edhe gjatë vizitës në institucion nga drejtuesit bashkëpunimi dhe koordinimi brenda institucionit zhvillohet në normalitet [takimi me dekanin, shefin e departamentit],</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UET është një institucion jo publik që ka një numër të vogël studentësh në këtë program studimi sepse ky është një program i ri studimi, por jo në numër programesh që ofron [lista e programeve]. Në funksion të programit të studimit “Master i Shkencave në “Infermieri”, institucioni ka angazhuar të gjithë strukturën dhe logjistikën që disponon si dhe ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të ndryshme të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, me institucionet shëndetësore publike dhe jo publike. Këtij qëllimi i shërben dhe programi 250+ krijuar midis UET dhe programe të studimit që ofron institucioni dhe kompani të ndryshme që u mundësojnë studentëve kryerjen praktikës profesionale, intershipeve të cilat ju shërbejnë për thellimin e njohurive dhe përfundimin e aftësive dhe kompetencave profesionale si dhe vendosjen e kontakteve me biznesin për punësimin etyre. [RVB, takimi me stafin drejtues, marrëdhënetet].</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikës mësimore dhe profesionale pranë spitaleve, qëndrave shëndetësore publike dhe jo publike dhe laboratorë mjekësorë si Marrëveshja me spitalin Salus, Poliklinikën Gjermanre, Spitalin Universitar të Traumës, Qendrën Spitalore Universitare “NënëTereza”, Spitalin Amerikan, ka bërë draft marrëveshje që pritet të miratohet me Qendrën për profesionistët e shëndetësisë në Tirol, që konsiston në kryerjen e praktikës profesionale të studentëve të bachelorit dhe mastër shkencor në këtë qëndër etj.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion GVJ konstatoi se programi ka formularin e aplikimit për praktikën profesionale, formularin e vlerësimit të praktikës profesionale nga petagogu mbikëqyrës, institucioni ku student ka kryer praktikën dhe formularin e vlerësimit nga student. Formulari i aplikimit për praktikën profesionale, plotësohet nga studentit dhe i dorëzohet koordinatorit të departamentit. Në këtë dokument studentit propozon</p>

	<p>institucionin ku ai preferon të kryejë praktikën profesionale (i cili përzgjidhet nga lista që UET-i ka vënë në dispozicion, ose propozohet nga studentit) dhe paraqet shkurtimisht objektivat që kërkon të realizojë gjatë praktikës [dokumenti praktikës, takimi me stafin akademik].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka një databazë lidhur me institucionet ku studentët kryejnë praktikën profesionale. Praktika mbikëqyret nga një kordinator i caktuar, kordinatori i programit i cili koordinon me institucionin ku studenti realizon praktikën profesionale. Realizimi i praktikës dhe vlerësimi kryhet sipas sylabusit dhe regullores përkatëse të FMT.</p> <p>[dokumenti praktikës, takimi me stafin akademik].</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Një vënd të rëndësishëm në marrëdhëniet e bashkëpunimit me universitetet jashtë vëndit zë lëvizja e studentëve në këto universite në kuadër të programit Erasmus+ me universitetin Almeria në Spanjë dhe Koc në Turqi, si dhe draft marrëveshja që pritet të miratohet me Qendrën për profesionistët e shëndetësisë në Tirol, që konsiston në kryerjen e praktikës profesionale të studentëve të bachelorit dhe mastër shkencor në këtë qendër. Këto marrëveshje shërbejnë për të shkëmbyer eksperiencë jo vetëm në programin mësimor, trajnime të ndryshme por dhe për tu njohur me mënyrën e jetesës, kulturën dhe traditat e vëndeve bashkëpunuese. Kështu gjatë viteve të fundit janë realizuar leksione të hapura me lektorë të huaj si Prof Henri Mash për eutanazinë, me lektor Italianë për teknikat në fizioterapi, leksione lidhur me situatën covid 19 organizuar me qendrën vullnetare të emergjencave mjekësore etj. Bashkëpunimi me student e diplomuar shtrihet dhe në kërkimin shkencor ku studentët ftohen të botojnë publikime të tyre në revistën Medicus, të marrin pjesë në konferencën ndërkombëtare "Ditë të studimeve Shqiptare" të organizuar nga UET ku studentët marrin pjesë aktive me anë të paraqitjes së punime të tyre. [takimi me stafin drejtues, RVB, dokumenti Trajnime të mëtejshme profesionale për studentët e diplomuar]</p>
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>Në mënyrë periodike njësi bazë harton raportin mbi realizimin e programit mësimor, opinionin e studentëve lidhur me logjistikën në funksion të programit, aktivitetet të kryera gjatë vitit akademik në funksion të programit të studimit, Raportin për përfitimet nga marrëveshjet. Ky raport siguron informacion lidhur me ndikimin e këtyre marrëveshjeve në bashkëpunimin midis personelit akademik dhe studentëve për shkëmbim eksperience, kërkimit shkencor, mobilitetit etj. Të dhënat e raporteve shërbejnë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, hartimin e politikave të zhvillimit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>Numri i studentëve në Mastër Shkencor në "Infermieri" ka qenë i pakët por në rritje (për vitin akademik 2018-2019, vetëm një studentë, për vitin akademik 2019-2020 pesë studentë dhe vitin 2020-2021, 9 studentë plus 4 transferime respektivisht 2 në vitin e parë dhe dy në vitin e dytë), pasi programi Msc në infermieri është një program i ri dhe viti 2020-2021 është</p>

	viti i tretë akademik që funksionon dhe për këtë arsye nuk ka patur shkëmbime studentore në kuadër të programe të bashkëpunimit Erasmus. FSHMT ka patur shkëmbime eksperiencë në kuadër të marveshjes me universitetin Cordova 2019-2021 të financuar nga Erasmus+. Pjesë e programeve të shkëmbimit të eksperiencës janë edhe pedagogët, ku mund të përmendet rasti i një pedagogu nga FSHMT ka qënë në Universitetin Szczecin në Poloni si lektore për studentët dhe specialistë të mjekësisë. [takimi me stafin drejtues]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.6	
Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	UET është institucion që motivon dhe mbështet veprimtarinë kërkimore shkencore bazuar në planin strategjik të zhvillimit të kërkimit shkencor në UET për vite 2021-2025 dhe plani strategjik për zhvillimin e programit në Master i Shkencave në "Infermieri" plani strategjik i zhvillimit institucional dhe programit të studimit. [takime me stafin akademik dhe studentët].
Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Institucioni ka njësin e projekteve dhe bashkëpunimit me jashtë e cila mbështet stafin akademik dhe student në kërkimin shkencor, asiston në shkrimin dhe realizimin e projekteve, realizimin e trajnimeve dhe konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare. Çdo dy vjet institucioni bën rishikim të aktivitetit shkencor të stafit akademik, botimeve, përmarrjes në aktivitete të ndryshme etj. [Raporti mbi përfitimet nga marveshjet, takime me stafin akademik dhe studentët].
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese. Kriteri 5. Institucioni inkurajon	Institucioni e ka të përcaktuar në rregulloren e mësimore të UET mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe pronësisë intelektuale dhe procedurën e ndjekur në rastin e plagjiaturës. Institucioni ka instaluar sistemin antiplagjiutër për punimet e temave të diplomave apo doktoraturave. Punimet shkencore apo temat e diplomave të realizuar në këtë institucion mbrohen sipronësisë intelektuale sipas legjislacionit në fuqi për të drejta e autorit . Institucioni promovon dhe inkurajon kërkimin shkencorë duke vënë në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve fond të veçantë për kërkim shkencorë, promovon botimet e tyre në revistën shkencore të universitetit Medicus si dhe mbështet financiarisht botimet në revista të tjera

studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	ndërkombëtare [takime me studentët dhe stafin akademik].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri”, është hapur në vitin 2018, me urdhër të MASH Nr. 665, datë 12.10.2018. Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike dhe i referohet nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), është i organizuar me 120 kredite (ECTS), kohëzgjatje 2 vite akademik, në gjuhën shqipe dhe kohë të plotë studimi, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e arsimit të lartë 80/2015. Në përfundim të studimeve lëshohet diplome “Master i Shkencave” në “Infermieri” [rregullorja e programit, plani mësimor].</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit është organizuar në përputhje me VKM 41 datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Programi i studimit Master i Shkencave në Infermieri përban një informacion të plotë në fushën e infermieristikës dhe sidomos në shërbime më specifike si infermier në shërbimin spitalor apo infermier në kujdesin shëndetësorë parësor.</p> <p>Njohuritë e fituara në këtë program studimi, i krijon mundësi studentit që të përshtatet me kërkesat e tregut të punës dhe zgjerimin e njohurive të tyre profesionale që i shërbejnë si bazë për kualifikime të mëtejshme. [programi, plani mësimor]</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. Në kurrikulën e tij përfshihen lëndë specifike për profilet të veçanta të infermierit që lidhen me nevojat e tregut të punës, lëndë specifike që lidhen me kërkimin shkencor, organizimin e strukturave shëndetësore.</p> <p>[rregullorja e programit, plani mësimor]</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të</p>	<p>Njohuritë e fituara i shërbejnë studentit për përfundimin e aftësive dhe kompetencave për të kryer në mënyrë të pavarur një kërkim bazë apo të avancuar në fushën e infermieristikës, për tu përballur dhe zgjidhur problemetika të lidhura me organizimin e stafit infermieror, menaxhimin e pacientit për të shërbyer pacientëve me etike dhe kujdesje profesionale, zgjidhjen e situatave komplekse dhe të paparishikuara me pacientin. Gjithashtu njohuritë e fituara në këtë program studimi shërbejnë si bazë për vazhdimin e studimeve të mëtejshme të doktoratës apo trajnimeve të tjera.</p>


<p>paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Bazuar në informacionet e marra nga takimi me studentët, ky program studimi i shërben kualifikimit të mëtejshëm profesional për të ushtruar profesionin e tyre në institucionet publike dhe jo publike spitalore apo shëndet publik. [rregullorja e programi, takimi me studentët].</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave nëInfermieri është i organizuar me kohë të plotë në dy vite akademik të ndarë nëkatër semestra në total 120 ECTS (ose 3000 orë mësimore) nga të cilat 12 ECTS i përkasin praktikës profesionale dhe 18 ECTS punimit të diplomës dhe provimit përfundimtar[plani mësimor].</p> <p>Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike të cilat në të dy semestrat janë organizuar në leksione(420 orë në auditor), seminare(210 orë mësimore në auditor), orë laboratorike dhe detyra kursi(140 dhe 130 orë mësimore në auditor), praktikë profesionale (300 orë në auditor), punim i diplomës (36 orë) në orë mësimore në auditor dhe orët jashtë auditorit. Frekuentimi i orëve teorike dhe praktike është i detyrueshëm për studentin në masën 80%. Kohëzgjatja e orëve të mësimit është 50 minuta. [Rregullorja e programit te studimit, dokumenti 14.1 Plani mësimor i programit].</p> <p>Në semestrin e dytë, studentët ndjekin praktikën profesionale pranë institucioneve/qendrave shëndetësore publike dhe jo publike me të cilat institucioni ka lidhur kontratë/marrëveshje bashkëpunimi. [marrveshjet, analiza e marrveshjeve]</p> <p>Lëndët e programitrealizohen sipas orarit mësimor të ndarë në semestra dhe ngarkesa e stafit akademik është e miratuar nga administratori [Rregullorja e funksionimit të programit, kurikula e programit, plani mësimor, ngarkesa mësimore e petagogëve, dokumenti i miratimit të ngarkesës së stafit akademik].</p> <p>Sylabusët janë të organizuar sipas kritereve të përcaktuar në VKM nr.41, datë 24.01.2018. Bazuar në ligjin Nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar kutitullari i lëndës është i kategorisë Profesor. <i>GVJ nga verifikimi i dokumentacioni konstatoi se ka lëndë që titullari i lëndës nuk është i kategorisë profesor.</i> Pjesë e programit të studimit është dhe praktika profesionale e cila është 12ETC ose 300 orë mësimore dhe kryhet sipas sylabusit përkatës dhe programit kalendarik në semestrin e dytë të vitit akademik(referuar dokumentit të planit mësimor).</p> <p>Praktikat profesionale të studentëve kryhen në institucionet shëndetësore publike ose jo publike më të cilat UET ka nënshkruar kontrata bashkëpunimi si Qendra Spitalore Uniiversitare Nënë Tereza, Spitali Universitarë i traumës, Spitalin Salus, poliklinika Gjermane, urdhri i Infermierit të Shqipërisë. Praktika profesionale mbikëqyret nga një udhëheqës i caktuar nga fakulteti dhe një staf nga institucioni ku kryhet praktika dhe vlerësohet nga pedagogu mbikëqyrës, institucioni ku kryhet praktika dhe vetë studentit.</p>

	<i>Për sa më sipër GVJ rekomandon që titullatët e lëndëve të përzgjidhen nga kategoria profesor[regullorja e praktikës profesionale,takimi me kordinatorin e programitdhe stafin akademik].</i>
Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	<p>Programi Master i Shkencave është i organizuar sipas VKM nr 41 datë24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartëku lëndët formueserealizohen në ETC dhe grupohen në</p> <p>A. Lëndë bazëme 12 ETC</p> <p>B. Lëndë karakterizuese,60ETC</p> <p>C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese18 ETC.</p> <p>D. Lëndë plotësuese:12 ETC</p> <p>E. Detyrime përmbyllës18 ETC</p> <p>Si lëndë të integruar në kategorinë C njësia bazë ofron dhe lëndët “Honors Course”. Këto lëndë ofrohen nga petagogë me tituj dhe gradë shkencore në përputhje me ekspertizën që ofrojnë dhe tematika e tyre është e ndryshme sipas viteve akademike. Këto kurse mund të ofrohen dhe në gjuhën angleze[takime me stafin drejtued dhe akademik].</p> <p>Lëndët e programit mësimor ndahen në dy topologji në bazë të të cilëve bëhet dhe vlerësimi i studentit.</p> <p>Lëndë të tipologjisë Parë përfshihen lënde me karakter praktik dheaplikative dhe lëndëtë tipologjisë dytë ku përfshihen lëndë teorike.</p>
Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	<p>Diplomimi i studentëve bëhet me temë diplome e cila vlerësohet në programin e studimit me 18ETC.</p> <p>Tema e diplomës udhëhiqet nga një pedagog pjestarëi stafit akademik. Proçedura që ndiqet për temën e diplomës përcaktohet me rregullore të miratuar nga dekani i Fakultetit të Shkencave mjekësore teknike. Departamenti në fillim të vitit akademik së bashku më bordin e punës diskuton tematikat e ndryshme që mund të jenëobjekt studimi për temat e diplomës. Tema e diplomës dhe pedagogët udhëheqës caktohen nga departamenti dhe miratohen nga dekani. Zgjedhja e temës bëhet nëfillim të vitit të dytëdhe në funksion të temës së zgjedhur studenti dhe pedagogu udhëheqës zhvillojnë seanca metodologjike sipas një kalendaritë shpallur.</p> <p>Studenti informohet me shkrim nga sekretaria mësimore për temën e diplomës dhe udhëhesin e saj të miratuar nga dekani.Dy javë përpara miratimit të diplomës student dorëzon në sekretarinë mësimore punimin e diplomës në formë të printuar dhe Cd, miratimin e temës së diplomës nga udhëheqësi i tij si dhe duhet të ketë shlyer të gjidha detyrimet që ka ndaj fakultetit, të ketë mbledhur të gjitha kreditet. Mbrotja e temës së diplomës kryhet përpara një komisioni të miratuar nga dekani . Vlerësimi i punimit bëhet me notë sipas mënyrës të përcaktuar në rregulloren e</p>

	<p>diplomimit.Kriteret për paraqitjen e punimit të diplomës mirtohen me rregullore të veçantë. {regullorja e programit të studimit}</p> <p>Çdo vit akademik dekani shpall punimin më të mirë të diplomës për vitin akademik dhe i akordohet çmimi i Presidentit për Diplomën më të mirë. [dokumenti mbi punimin e diplomës].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>UET është organizuar bazuar në ligjin Nr. 80/2015, date 22.07.2015 “Për Arsimin elartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutuset të tij dhe zhvillon aktivitetin e tij në selinë në Tiranë.Institucioni përbëhet nga njësitë kryesore, bazë, ndihmës akademike dhe administrative dhe organet këshilluese(bordet e ndryshëm).</p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	<p>Organet akademike janë senati akademik, asambleja e stafit akademik, komisionet e përhershme për dhënien e gradës shkencore “doktor” dhe promovimin e titujve akademik, këshilli etikës dhe autoritet akademike(rektori, dekanët, drejtuesit e njësisë bazë dhe qëndrës kërkimore shkencore). Organet administrative janë bordi i administrimit, administratori i universitetit, njësite kryesore [statusi i UET].</p> <p>Gjithashtu UET ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në vitin 2009 dhe riakredituar në nivel institucional në vitin 2017 me vendim të BA nr.12, datë 07.04.2017 me vlefshmeri akreditimi deri në vitin 2022.Programet e studimit që ofron institucioni janë akredituar ose janë në proces akreditimi nga institucionet përgjegjëse.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri”zhvillohet në Fakultetin e Shkencave Mjekesore Teknike i cili është hapur me Urdhërin Nr. 530, date 04.09.2018 të MASH ku zhvillohen shtatëprograme studimi Bachelor, mastër shkencor dhe professional në Infermieri, Fizioterapi dhe Imazheri.</p> <p>Fakulteti i Shkencave MjekësoreTeknike(FSHMT) përbëhet nga tre departamente, Departamenti i infermierisë dhe fizioterapisë, departamenti i imazherisë dhe Qendra e kërkimeve shkencorenë Shëndetin Publik.</p> <p>Në realizimin e programevetë studimit në FSHMT janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradën</p>

	<p>shkencorë apo Msc.</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuarnë FSHMT 29(njzete nëntë) pedagogë prej të cilëve 21(njzetenjë) ose 72.4 % janë PAE dhe 8(tetë) janë PAK. Përbërja e stafit akademik sipas departamenteve është si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> Departamenti i fizioterapisë dhe infermierisë janë angazhur në mësimdhënie 14(katërbëdhjetë) pedagogë prej të cilëve 7(shtatë) janë PAE dhe 7(shtatë) PAK). Nga PAE 3(tre) janë të kategorisë profesor, 1(një) me gradën doktor shkencash dhe 3(tre) janë Msc. Nga PAK 1(një) është doktorë shkencash dhe 6(gjashtë) janë Msc(SPA). Departamenti i imazherisë janë angazhuar në mësimdhënie 8(tetë) pedagogë prej të cilëve 7(shtatë) janë PAE dhe 1(një) PAK. Nga PAE 4(katër) janë me gradën doktor shkencash dhe 3(tre) janë Msc/SPA. Nga PAK 1(një) është Msc(SPA). Qendra e kërkimeve në shëndet publiku janë angazhuar 7(shtatë) pedagogë prej të cilëve 2(dy) janë të kategorisë profesor, 2(dy) janë doktorë shkencash dhe 3 janë Msc.
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Infermieri” ofrohet nga Departamenti i infermierisë dhe Fizioterapisë, në Fakultetin e Shkencave Mjekesore Teknike. Ky program studimi është hapur me UMASH Nr. 665, datë 12.10.2018 dhe ofrohet me 120 kredite (ECTS), kohëzgjatje 2 vite akademik, në gjuhën shqipe dhe kohë të plotë studimi, Në përfundim të studimeve lëshohet diplome “Master i Shkencave” në “Infermieri.</p> <p>Në këtë departament realizohen pesë programe studimi si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - bachelor në infermieri - bachelor në fizioterapi, - mastër shkencor në infermieri - mastër shkencor në fizioterapi - mastër profesional në infermieri <p>Në realizimin e programeve të studimit në Departamentin e infermierisë dhe fizioterapisë janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradën shkencorë apo Msc.</p> <p>në vite si vijon:</p> <p>Për vitin 2020-2021 raporti PAE/PAK është 50% me 50%</p> <p>Për vitin 2019-2020 raporti PAE/PAK është 44.5% me 55.5%</p> <p>Për vitin 2018-2019 raporti PAE/PAK është 63.6% me 36.4%</p> <p>Struktura akademike e departamentit në vite është si vijon:</p>




	<p>Për vitin 2020-2021 janë angazhur në mësimdhënie 14(katërbëdhjetë)pedagogë prej të cilëve 7(shtatë) janë PAE dhe 7(shtatë)janë PAK.</p> <p>Nga PAE 2(dy) janë të kategorisë profesor, 1(një)me gradën doktor shkencash dhe 4(katër) janë Msc.Nga PAK 1(një) është doktorë shkencash dhe 6(gjashtë) janë Msc(SPA).</p> <p>Për vitin 2019-2020 janë angazhuar në mësimdhënie 18(tetëmbëdhjetë) pedagogë prej të cilëve 8(tetë) janë PAE dhe 10(dhjetë) janë PAK.</p> <p>Nga PAE 3(tre) janë të kategorisë profesor, 1(një) ështëme gradën doktor shkencash dhe 4(katër) janë Msc.Nga PAK 3(tre) janë të kategorisë profesor, 2(dy) janë doktorë shkencash dhe 5(pesë) janë Msc(SPA).</p> <p>Për vitin 2018-2019 janë angazhur në mësimdhënie 11(njëmbëdhjetë) pedagogë prej të cilëve 7(shtatë) ose 63.6% janë PAE dhe 4(katër) PAK.</p> <p>Nga PAE 1(një) është profesor, 8(tetë) janëme gradën doktor shkencash dhe 4(katër) janë Msc.Nga PAK 2(dy) janë të kategorisë profesor, 1(një) është doktorë shkencash dhe 1(një) është Msc(SPA).</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p> <p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> <p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë</p>	<p>Programi i ciklit të dytë Mastër shkencor në Infermieri është hapur në vitin akademik 2018-2019 dhe për realizimin e procesit mësimor në këtë programi studimit janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradën shkencorë apo Msc.</p> <p>në vite si vijon:</p> <p>Për vitin 2020-2021 janë angazhuar 12(dymbëdhjetë) staf akademik prej të cilëve 9(nëntë) janë PAE dhe 3(tre) janë PAK.</p> <p>Nga PAE 3(tre) janë të kategorisë profesor 5(pesë) janë doktorë shkencash dhe 1(një) është Msc.</p> <p>Nga PAK 1një(është) doktorë shkencash dhe 2(dy) janë Msc.</p> <p>Për vitin 2019-2020 janë angazhuar 12(dymbëdhjetë) staf akademik prej të cilëve 7(shtatë) janë PAE dhe 5(pesë) janë PAK .</p> <p>Nga PAE 6(gjashtë) janë të kategorisë profesor 1(një) është doktorë shkencash.</p> <p>Nga PAK 1(një) është profesor,2(dy) janë doktorë shkencash dhe 2(dy) janë Msc.</p> <p>Për vitin 2018- 2019 janë angazhuar 9(nëntë)staf akademik prej të cilëve 8(tetë) janë PAE dhe 1(një) është PAK.</p> <p>Nga PAE 4(katër) janë të kategorisë profesor 4(katër) janë doktorë shkencash.</p> <p>Nga PAK 1(një) është doktorë shkencash.</p> <p>Në këtë program studimi raporti PAE/PAK në vitet 2018-2021 është si vijon :</p>

<p>periodike te drejtuesi i njesisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> - vitet 2020-2021raporti PAE/PAK 75% me 25% - vitet 2019-2020raporti PAE/PAK58.3 % me 41 .7% - vitet 2018- 2019raporti PAE/PAK88% me 12% <p>Moshae stafit akademik të përfshirë në programin e studimit është realtivisht e re ku 50% e stafit akademik i përkasin grup mosësh 35-65 vjeçdhe kanë titujt doktorë shkencash.</p> <p>Nga vlerësimi i të dhënave GVJ konstaton se në vite ka rënie të numrit të PAE në departament, ndërsa në këtë program studimi konstatojmë se ka ritje të PAE me tituj dhe gradë shkencore, të cilët realizojnë82% të orëve të programit mësimor që zhvillohet në këtë program studimi.</p> <p><i>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion GVJ konstaton seka personel ndihmës admunitsrativpor nuk ka personel ndihmës akademik , në program për realiziminorëve laboratorike klinike dhepraktikave mësimore</i></p> <p>Programi ka një koordinator të emëruar ngadekani i Fakultetit të Shkencave MjekësoreNr.74 datë 22.12.2020i cili është staf akademik me kohë të plotë që ka formimin dhe kualifikimin e duhur për të kryer këtë funksion.</p> <p>Koordinatori i programit përgjigjet për organizimin dhe realizimin e programit mësimor dhe praktikës profesionale, përgatitjen e sylabuseve sipas një formati të miratuar dhe raporton rregullisht tek shefi i njësisë bazë dhe dekani i FSHMT.</p> <p>Detyrat dhe mënyra e raportimit janë të dokumentuar në rregulloren e funksionimit të programit të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p style="text-align: center;">X</p>	

Standardi II.3 Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në</p>	<p>FSHMT ku zhvillohet programi i ciklit të dytë të studimit Mastër Shkencor në Infermieri, disponon gjithë informacionin lidhur me organizimin, strukturën, përmbajtjen dhe realizimine programit të studimit.</p> <p>Pranë departamentit të fizioterapisë dhe infermierisë ku zhvillohet ky program studimi gjendet infromacioni për programin mësimor, për sylabuset që zhvillon programi të ndara në leksione, seminare, punë laboratorike, praktikë profesionale, orët brenda dhe jashtë auditorit, mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe frekuentimin e programit, literaturën bazë dhe ndihmëse në funksion të programit të studimit, detyrimeve dhe të</p>

<p>përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p> <p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p> <p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p> <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>drejtat e studentit etj. Me fillimin e vitit akademik programi i studimit dhe syllabuset ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi.</p> <p>[regullorja e përgjithshme e UET, regullorja e programit]</p> <p>Programi i studimit Mastër Shkencor në Infermieri është hartuar sipas VKM nr. 41 datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë ku është ruajtur raporti në përqindje i shpërndarjes së veprimtarisë formuese në kategori të veçanta.</p> <p>Programi i studimit Mastër shkencor në infermieri është i organizuar në lëndë formuese dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të vlerësimit të cilat zhvillohen në dy vite akademike të ndara në 4 semestra.</p> <ul style="list-style-type: none"> A. Lëndë bazë 5-10%/12 ETC B. Lëndë karakterizuese, 50-60%/60ETC C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese 12-20%/18 ETC. D. Lëndë plotësuese/praktika profesionale :10% 12 ETC E. Detyrime përmblylës provimi punimi diplomës 10-15%/ 18 ETC <p>Kurikula e programit përbëhet nga 15 lëndë, praktika profesionale dhe provimi përfundimtarë/temë diplome, në total 17 lëndë.</p> <p>GVJ gjatë vlerësimit të përmbajtjes së programit të studimit konstaton shpërndarje në mënyrë të barabartë të ETC në lëndët formuese prej 6 ETC. Mbështetur në strukturën dhe lëndëve të programit lidhur me profilin e tij rekomandon rishpërndarje të krediteve midis lëndëve karakterizuese duke i dhënë prioritet lëndëve të profilit infermieror.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatoi se dosja e programit përmban informacionin e plotë për këtë program studimi si syllabuset të cilat janë hartuar sipas kriterëve të përcaktuar në VKM 41 datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” ,por në disa syllabuse titullari i lëndës nuk është i kategorisë profesor.</p> <p>Syllabuset e lëndëve formuese dhe praktikës profesionale përmbajnë informacionin e nevojshëm lidhur me lëndën e programit si numrin e krediteve, kohën e zhvillimit të saj, mënyrën e vlerësimit të studentit si dhe literaturën që mund të shfrytëzojë studenti e cila është e 5 viteve të fundit. Literatura bazë është në gjuhën shqipe dhe ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj. Kontrolli i dijeve të studentit bazohet në regulloren e programit i cili kryhet në mënyrë të vazhdueshme sipas lëndëve të tipologjisë së dytë :</p>
---	---

	<p>Diskutimi në Seminare 10%</p> <p>Detyra kursi 20%</p> <p>Provimi përfundimtarë 70%.</p> <p>Vlerësimi bëhet me pikë nga 0-100 pikë të cilat konvertohen në notë sipas rregullores së programit. Studenti njihet me mënyrën e vlerësimit në fillim të vitit akademik.</p> <p>[programi studimit, plani mësimor, sylabuset e lëndëve].</p> <p>GVJ nga shqyrtimi idokumentacion dhe vizitës në institucion në sekretarinë mësimore konstaton se institucioni ka një informacion të plotë për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programet e studimit. UET në përputhje me kartën e Bolonjës pranon transferime të studentëve nga IAL të tjera publike dhe jo publike vëndase dhe të huaja si dhe transferimin e studentëve të saj në IAL të tjera. Studenti duhet të ndjekë në UET së paku një vit akademik dhe të zotëroj së paku 25ETC të lëndëve të kategorisë A-Dsi dhe të përmush detyrimet përmbyllëse në kategorinë E të programit të studimit. Vlerësimi i kurikulës dhe njohja e krediteve bëhet nga komisioni i njohjes pranë departamentit. Kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit, transferimet dhe ekuivalentimet realizohet sipas rregulloreve përkatëse të UET dhe programit të studimit të miratuara nga rektori [regullorja e UET, regullorja e transferimeve, regullorja e programit]</p> <p>Në njësinë bazë ku zhvillohet programi i ciklit të dytë të studimit masteri shkencor gjendet informacioni lidhur me sylabuset që zhvillon programi të ndara në leksione, praktikë profesionale, orët brenda dhe jashtë auditorit.</p> <p>Programi mësimor përmban 120 ETC, nga 60ETC për cdo vit akademik. Për cdo vit akademik programi mësimor është i organizuar në 2 semestra, 15 javë mësimore/semestër, në total 4 semestra dhe 30 javë mësimore. Koha normale për përfundimin e studimeve është 2 vite dhe afati maksimal 4 vite. Programi mësimor realizohet në 3000 orë mësimore në total nga 1500 orë mësimore/vit akademik, prej të cilave 300 orë mësimore janë të praktikës profesionale, 1764 orë mësimore studim individual dhe 1236 orë mësimore në auditor të ndara në leksione , seminare, laboratore të shprehur në ETC. 1 ETC është 25 orë mësimore pune studentinë auditor dhe jashtë auditorit/ punë e pavarur. [regullorja e programit].</p> <p>Kurikula dhe struktura e programit janë hartuar nga pedagogët e UET Programi mastër shkencor në infermieri është një program I ri studimi, 3 vite akademike, por bazuar në eksperiencën e institucionit rishikimi dhe përditësimi i programit bëhet në fillim të vitit akademik bazuar në sygjerimet e studentëve dhe pedagogëve të programit të studimit. Dokumentacioni i hartimit dhe rishikimit të programit pasi miratohen nga</p>
--	--

	titullari institucionit arkivohen në institucion në gjuhën shqipe. [takimi me kordinatorin e programit dhe pedagogët].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi i studimit është organizuar në leksione, seminare dhe praktika profesionale mengarkesën përkatëse në kreditë konvertuar në orë mësimore në auditor dhe jashtë auditorit/punë të pavarur të studentit [bazuar në legjislacionin në fuqi, kurikula e programit]. Shpërndarja e ngarkesës mësimore e stafit akademik përcaktohet nga vetë institucioni dhe miratohet nga administratori i institucionit në fillim të vitit akademik. Ngarkesa mësimore përcaktohet sipas poicionit që ka pedagogu në insttucion(rektor,dekan, zv.rektor, zv dekan, shef departamenti), shkallën e kualifikimit(titulli akademik,gradashkencore) sipas kohës së angazhimit në programin e studimit siPAE ose PAK. Orët mësimore fizike llogariten në bazë të koeficientëve të konvertimi për leksione, seminare, praktika laboratorike mësimore, udhëheqës teme diplome/ doktorature sipas nivelit të programit të studimit.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Përveç mësimdhënie stafi akademik angazhohet në procese të tjera akademike të cilat i llogariten si ngarkesë mësimore[dokumenti i llogaritjes së ngarkesës mësimore]. Ndarja në kategori (A në E) dhe ngarkesa në krediteve (në %)për veprimtaritë formuese përputhet me legjislacionin në fuqi VKM 41 datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.
Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre teorike dhe praktike në fushën e infermieristikës, organizmit dhe manaxhim pacientit, kërkimit shkencor si dhe zgjidhjen e probleme të vecanta strukturat shëndetësore spitalore apo parësore dhe përshtatjen e tyre në tregun e punës. [programi, rregullorjaFM.]
Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Organizmi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore ore/ETCS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik	

<p>mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>programi, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive dhe kompetencës të nevojshme.</p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Me njohuritë e mara në këtë program, studentët e ndjejnë veten të aftë në vendet e tyre të punës dhe dijet e mara janë në funksion të plotë të veprimtarisë së përditshmetë tyre në fushëm e organizimit, kërkimit shkencor. [takimi me studentët].</p>
<p>Kriteri 7. Përmbytja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Lëndët dhe praktika në program si dhe ngarkesa e tyre në kredite/orë mësimore përputhet me profilin e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 8. Përmbytja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin drejtues dhe akademik u deklarua se programi është i ngjashëm me programe të IAL të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare duke ju mundësuar studentëve punësimin jo vetëm në shqipëri po dhe në vëndet e rajonit dhe vënde të tjera të BE. (Referuar takimit me stafin drejtues të UET dhe stafin akademik, programi mësimor).</p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbytjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Programi i studimit ju mundëson studentëve transferimin e tyre në programe të ngjashme në IAL të tjera brënda dhe jashtë vëndit. Procesi i transferimit dhe njohjes së kreditëve bëhet sipas rregullores së UET dhe programit të studimit. Njohuritë e mara në këtë program dhe kurikula e tij ju krijon mundësi punësimi studentëve në sektorin shëndetësor spitalor ose parësor publik dhe jo publik.</p>
<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Program i studimit mastër shkencor në infermier, është program i ri studimi. Bazuar në eksperiencën e UET hartimi dhe rishikimi i programit të studimit kryhet nga pedagogët që zhvillojnë programin e studimit si dhe syzjerimet e studentëve dhe miratohen nga dekani FSHMT.</p>
	<p>Përmbytja e programit i shërben studentëve për thellimin e njohurive të përfuara në ciklin e parë të studimit dhe orientimine tyre në një fushëm më të specializuar të infermierisë si në shërbimin spitalor dhe atë ambulator, në fushëm e organizimit, kërkimin shkencor. Programi i studimit ju mundëson studentëve përfundimin e shprehive, aftësive dhe kompetencës së nevojshme në ushtrimin e profesionit të tyre dhe përshtatjen me tregun e punës.</p>
	<p>Institucioni, u ka ofruar mundësi studentëve mundësi për trajnime, kërkime dhe mobilitet të studentëve dhe pedagogëve në institucione jashtë vëndit në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka me institucione të ndryshme ndërkombëtare, apo projekteve Erasmus .Në këto programe nuk ka patur studentë nga programi Mastër shkencor në inferimieri sepse ky është program i ri [takimi pedagogë, RVB].</p>
	<p>Programi i studimit është i hartuar në mënyrë të tillë që ju siguron studentëve informacionin e duhur për thellimin e njohurive në fushëm përkatëse të kërkimit shkencor dhe krijon bazën për vazhdimin e mëtejshëm të studimeve të doktoratës apo kualifikimit të tyre në përshtatje</p>

	<p>me kërkesat e tregut të punës. [programi, rregullore, plani] studimit]</p> <p>Hartimi dhe strukturimi i përmbatjes së programit bëhet me propozim të stafit akademik duke ju referuar nevojave të tregut të punës kombëtar dhe ndërkombëtar për infermier të specializuar, interesimit apo kërkesa vetë studentëve për tu përfshirë në kërkim shkencor.</p> <p>UET ka një eksperiencë të mirë shumë vjeçarë në strukturimin apo përmirësimin e programe studimit, apsi në këtë process mer parasysh edhe kërkesat dhe sygjerimet e bordit të punës të cilat pasyrojnë nevojat dhe kërkesat e tregus të punës vëndas duke ju shërbyer punësimit të studentëve[takimi me stafin drejtues dhe studentët].</p> <p>Program i studimit ka një harmonizim të orëve teorike e praktike çka ju mundëson studentëve thellimin e njohurive në fushën e kërkimit shkencor dhe përgatit bazën e dijeve për vazhdimin e doktoraturës dhe kualifikime të mëtejshme.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi II.5</p> <p>Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin Master i Shkencave në infermieri përmbush në përgjithësi kërkesat ligjore në fuqi. Ai përbëhet nga pedagogë me eksperiencë që kanë kualifikimin e duhur dhe kompetencën profesionale për lëndët përkatëse që ata zhvillojnë në program. Shpërndrja e ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me shkallën e kualifikimit, pozicionint që ka në institucion, kriterit që pedagogu nuk mund të ketë më shumë se dy lëndë në semestër dhe në të njëjtin program studimi [Cv e stafit akademi].</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik efektive dhe me kontratë i angazhuar për realizimin e programit të ciklit të dytë të studimit Mastër shkencor në infermieri për vitet akademike 2018-2021 zotërojnë tituj akademik dhe gradën shkencorë doktorë, eksperiencë në mësimdhëniesi dhe kompetencën profesionale dhe akademike, që në përgjithësi përputhet me lëndët që ata zhvillojnë në këtë program mësimor, Por nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatoi se :</p> <p>- në këtë program studimi ka pedagogë që formimi i tyre</p>

<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p><i>profesional dhe ekspertiza nuk përputhet me lëndët që zhvillojnë në program. Psh pedagog me formim biologji zhvillojnë lëndë mjekësore si mjekësi laboratorike, mikrobiolgi, biokimi mjekësore</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - në vite ka rritje të stafit akademik me tituj dhe gradë shkencore. - Personeli akademik efektive zhvillon rreth 82% të ngarkesës mësimore të programit. 			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Të dhënat në shifra për stafin e angazhuar në këtë program studimi janë pasqyruar në standartit II.4 [tabelat përmbledhëse, CV e stafit akademik].</p> <p>Praktika profesionale zë një vënd të rëndësishëm në programin mësimor dhe ka 12 ETC dhe realizohet në semestrin e dytë. Praktika realizohet sipas sylabusit përkatës dhe mbikqyret nga pedagogë të programit, personi i kontaktit në strukturat shëndetësore ku realizohet praktika profesionale me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. Viti i studimit përmbillet me temën e diplomës e cila ka 12 ETC. Procedura që ndiqet për miratimin, zhvillimin dhe mbrotjen e temës së diplomës janë të miratuar me rregulloren përkatëse të miratuar nga dekani i fakultetit të Shkencave Mjekësore teknike. Institucioni ka data bazame të dhëna mbi institucionet ku kryhet praktika , personat e kontaktit që mbikqyrin studentit gjatë kryerjes së praktikës [regullorja e programit, regullorja e diplomimit, tabela 1.6 tabela përmbledhëse e praktikës profesionale].</p> <p>Në RVB referohet se institucionianagazhon staf ndimespër realizimin e praktikës laboratorike, <i>por GVJ nuk e konstaton këtë në dokumentacion e vënë në dispozicion mbi stafin e angazhuar në këtë program studimi [Cv e stafit].</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i</p>	<p>Institucionii kushton një vëmëndje të rëndësishme hartimit dhe rishikimit të programeve të studimit në bashkëpunim të stafit akademik dhe anëtrët e bordit të punës duke bazuar në studimin e tregut të punës kombëtar dhe më gjërë. Nevoja për infermier të kualifikuar është në rritje çka doli në pah dhe gjatë periudhës së pandemisë nga Covid 19 [takimi me stafin drejtues].</p> <p>Institucioni ka tashme një eksperiencë të mirë në bashkëpunimin me studentët dhe përfshirjen e tyre në vendimarrjet në programin e studimit lidhur me vlerësimin dhe rishikimin e tyre. Studentët marrin pjesë në mbledhjet e departamentit të cilët zhvillohen të hapura për studentët e programit një herë në muaj duke ju mundësuar</p>

punës.	<p>studentëve të shprehinmendimin e tyre rreth programit të studimit, kërkemat, propozimet e tyre për përmirësime.</p> <p>Departamenti mban kontakte me studentët nëpërmjet sistemit të Alumni-t nëpërmjet të cilit konsultohen në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe marrin prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit si dhe informacion për nevojat e tregut të punës për infermier të specializuar.</p> <p>Përvojë e mirë e këtij institucioni është përfaqësimi i studentëve në senat, KSBC, keshillin e etikës [regulloret e institucionit].</p> <p>Institucioni ka një databazë për studentët që ndjekin studimet në programet e studimit si dhe studentët e diplomuar prej të cilëve merr dhe informacion për kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë në punësimin e studentëve.</p> <p>Nëse lind nevoja për rishikim apo riorganizim programi i studimit institucioni mbështetet dhe në informacionet e përftuar nga bashkëpunimet me institucionet publike apo private, kërkesat dhe nevojat e tregut të punës për specialistë shëndetsësorë në fushën e specializuar nëpërmjet përfaqësuesve të këtyre institucioneve në bordin e tregut të punës dhe në përfundimet apo rezultatet e kërkimit shkencor në universitet. [takimi me stafin drejtues, stafin akademik, regulloret e UET].</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>				
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>				
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.7</p>	
<p>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me</p>	<p>Programi i studimit “Mastër shkencor në infermieri ka si objektivi kryesor formimin akademik dhe shkencor bashkëkohor të infermierit, orientimin e infermierëve të specializuar drejt kërkimit shkencor dhe ofrimin studentëve të një diplome cilësore në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke u</p>


objektivat madhorë të institucionit.	mbështetur në prioritet strategjike dhe zhvillimin ekonomik të vëndit. [plani strategjik I zhvillimit të programit]			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Njësia kryesore dhe bazë ku zhvillohet ky program studimi organizon dhe administron aktivitetin mësimdhënies, aktivitetet dhe veprimtaritë kërkimore shkencor dukerespektuar opinionet, idetë dhe metodat në garantimin e zhvillimit të lirë, kritik dhe krijues të procesit të mësimdhënies, aktivitetit kërkimor shkencor dhe veprimtarive të tjera akademike. Cdo të martë institucioni organizon forumet me personalitete nga fusha të ndryshme përfshirë dhe mjekësinë të cilët bashkëbisedojnë me pedagogët dhe studentët për problemëtika të vecanta lidhur me profesionin. Gjithashtudrejtesit e FSHMT dhe departamentit nxison studentët dhe stafin akademik të marin pjesë në konferencën Ditët e studimeve Shqiptare, ku departamenti ka seksionin e tij.			
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Program i studimit i motivon studentët të përfshihen nëpunë të mirëfilltë projektuese dhe kërkimore që kontribuojnë në formimin profesional dhe shkencor. Në bazë të ekspertizës së tyre, anëtarët e departamentit janë përfshirë në projektet e mëdha kërkimore që përbëjnë shtyllën e kërkimit shkencor në UET. Dy pedagogë nga departamentiku zhvillohet ky program studimi janë përfshirë në dy projekte ku kanë angazhuar dhe 5 studentë nga ky program studimi. Studentët janë angazhuar në mbledhjen e të dhënave, organizimin e seminare, konferencave shkencore dhe trainuese, dhe pjesëmarrjen në këto aktovtete duke paraqitur rezultatet e puniveve të diplomës apo projekteve ku janë përfshirësi dhe publikimin e këtyre punimeve në revistën shkencore të fakultetit apo revista të tjera [tabelat përmbledhës, lista e aktiviteteve dhe projekteve] .			
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Programi studimi është fokusuar në identifikimin e problemeve në fushën e kërkimit dhe kërkimit shkencor në nivel kombëtar dhe rajonal të cilat janë pasqyruar dhe në planin strategjik të zhvillimit shkencor të UET dhe të këtij program studimi [plani strategjik i zhvillimit të programit] .			
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	Për koordinimin, organizimin dhe realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimor shkencore institucioni ka ngritur njësinë e projekteve dhe kërkimit shkencor të cilat mbështesin dhe informojnë stafin akademik në përfshirjen e tyre në thirrjet që organizon institucioni për thithjen e projekte të ndryshme me fonde të brëndshme të vetë institucionin apo me fonde nga burime të tjera financimi kombëtare apondërkombëtare.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>UET i kushton një rëndësi të veçantë harmonizimit të aktivitetit mësimor me atë kërkimor shkencor ku një vëndje të veçantë i kushtohet përfshirjes së studentëve në kërkim shkencor. Institucioni ka nisur investimin për ndërtimin e ambienteve të paisur me teknologji të mirfilltë për realizimin e eksperimenteve të kërkimit shkencor. Gjithashtu, për realizimin e aktiviteteve kërkimore shkencore institucioni çdo vit akademik planifikon një buxhet të veçantë nga të ardhurat e tij si dhe bashkëpunon me institucione publike dhe jopublike vëndase dhe të huaj. FSHMT për realizimin e punëve kërkimore shkencore ka marrveshje bashkëpunimi me strukturat spitalore universitare të cilat vënë në dispozicion të dhënat nga kartelat klinike apo arkiva [marrveshjet e bashkëpunimit].</p> <p>Për realizimin e objektivave të kërkimit shkencor institucioni ka njësinë e kërkimit shkencor dhe projekteve e cila informon stafit për thirjet e projekteve me fonde të brëndshme të institucionit apo fonde nga burime të tjera. Asiston stafin në shkrimin dhe përgatitjen e projekteve dhe pas miratimit monitoron zbatimin dhe realizimin e tyre. Pjesë e këtyre projekteve janë dhe studentët të tre cikleve të studimit.</p>			
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Pjesë e rëndësishme e aktivitetit mësimor dhe kërkimor shkencor është organizimi i aktiviteteve trainuese, seminareve dhe konferencave nga njësia kryesore në fusha dhe probleme të vecanta të mjekësisë. Ku përmendim open eek. Ditët e shëndetësisë, kongresi ndërkombëtar i hematologjisë, grupi kërkimor i mjekësisë etj ku studentët janë pjesëmarrës aktive në këto aktivitete nëpërmjet parqitjes së temave të studimit, rezultateve të projekteve ku kanë qënë pjesëmarrës me pedagogët e tyre apo botime në revista shkencore të universitetit. [dokumneti 43.2 të dhena mbi aktivitetin e FSHMT, departamenti i infermierisë dhe fizioterapisë].</p> <p><i>Panvarsisht aktiviteve të zhvilluara, GVJ vlerëson që numri i tyre duhet të rritet dhe gjithashtu të rritet cilësia e tyre.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>Pjesë e rëndësishme e aktivitetit mësimor dhe kërkimor shkencor është organizimi i aktiviteteve trainuese, seminareve dhe konferencave nga njësia kryesore në fusha dhe probleme të vecanta të mjekësisë. Ku përmendim open eek. Ditët e shëndetësisë, kongresi ndërkombëtar i hematologjisë, grupi kërkimor i mjekësisë etj ku studentët janë pjesëmarrës aktive në këto aktivitete nëpërmjet parqitjes së temave të studimit, rezultateve të projekteve ku kanë qënë pjesëmarrës me pedagogët e tyre apo botime në revista shkencore të universitetit. [dokumneti 43.2 të dhena mbi aktivitetin e FSHMT, departamenti i infermierisë dhe fizioterapisë].</p> <p><i>Panvarsisht aktiviteve të zhvilluara, GVJ vlerëson që numri i tyre duhet të rritet dhe gjithashtu të rritet cilësia e tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	<p>UET ka hartuar disa rregullore për funksionimin e institucionit dhe programit të studimit të miratura nga titullari i institucionit. Rregullorja e programit të studimit, përcakton organizimin e programit të studimit, elementët e mësimdhënies në programin, procesin e vlerësimit dhe testimit të njohurive.</p> <p>GVJ në takimin me stafin akademik konstatoi senë program e studimit zbatohen metoda inovative, platforma dhe sisteme që ndërthurin metodikën standarde të mësimdhënies me ato online.Përdorimi i platformës online gjeti përdorim në kohën e pandemisë Covid 19 ku UET hartoi dhe rregullore të veçantë për organizimin e procesit mësimor në tre ciklet e studimit on line [takimet me stafin dhe studentët, rregulloret e organizimit të procesit mësimor gjatë pandemisë së Covid 19].</p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	<p>Për monitorimin e mësimdhënies dhe cilësisë së saj, institucioni ka në funksionim NJSBC e cila në bashkëpunim me Zv/ Rektoren për procesin mësimor, Dekanët, Drejtuesit e Departamentit dhe Sekretarinë e Përgjithshme kryhen monitorimin në mënyrë periodike të personelit akademik dhe administrative.</p>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	<p>Komisioni monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike procesin mësimor, aftësitë e stafit akademik bazuar në pyetësonin e studentëve, ndjekjen e orëve mësimor në auditor, aktivitetin e tyre shkencor si dhe kontributin e tyre në funksion të institucionit si dhe intervistës individuale me pedagogët brëndshëm apo të jashtëm lidhur me kryerjen nga pedagogu të të gjitha detyrimeve kontraktuale me cilësinë dhe sasinë e duhur [RVB, takimi me stafin akademik, formularët e vlerësimit].</p>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>Institucioni në mënyrë periodike çdo vit vlerëson metodat e mësimdhënies nëpërmjet realizimit me sondazh/fokus grup të plotësimin të pyetësorit të vlerësimit nga studentët. Studentëtshprehin vlerësimet e tyre për procesin e mësimdhënies, vlerësimin e tyre nga stafi akademik si dhe problematikat e ndryshme të hasura gjatë vitit akademik. Përfshirja e studentëve në vlerësimin e performancës së pedagogëve jonetëm për cilësinë emësimdhënie por dhe mënyrën e sjelljes, komunikimit me studentit, mbështetjen e tyre shërbejnë për evidentimin dhe adresimin e problematikave të ndryshme të studentëve.</p>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	<p>Rezultatet për vlerësimin e dhënë nga studentët bëhen publike për të gjith stafin akademik në formë të personalizuar nga njësia e sigurimit të cilësisë në bashkëpunim me sektorin e IT dhe dekanin e FSHMT. Formulari i vlerësimit të pedagout nga studentët është i aksesueshëm për studentit. Rezultatet dhe informacionet e marra nga sondazhet i shërbejnë përmirësimt të punës në</p>

	<p>institucion dhe të stafit akademik, rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe zbatimit të metodologjisë bashkëkohore në formimin e studentëve. Komisioni i vlerësimit të brëndshëm të cilësisë përveç vlerësimit të performancës së petagogut nga studenti, kryhen intervistën individuale me secilin pedagog për realizimin e detyrimeve të pedagogut ndaj institucionit bazuar në kontratën e punës individuale. Këtij vlerësimi i nënshtrohen dhe PAK që udhëheqin tema diplome apo doktoratura. Komisioni harton raportin e vlerësimit të performancës së pedagogut dhe një kopje dorëzohet në drejtorinë e burimeve njerëzore[regullorja e NJSCB].</p> <p>Për promovimin e shëmbujve dhe praktikave më të mira institucioni përdor mënyra të ndryshme si trajnime të stafit akademik për rifreskim të njohurive lidhur me kërkesat dhe standartet e cilësisë, metodat e mësimdhënies, mbështetje financiare për pjesmarje në aktivitete shkencore etj[lista e aktiviteve].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Përrealizimin e procesit mësimor UET përdor metoda të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, praktika profesionale, detyra kursi, tema diplome si dhe leksione të hapura të organizuara nga departamenti</p> <p>Gjatë mësimdhënies përdoren metoda alternative si prezantime në Poëer Point, biseda interaktive me studentët apo temave të vecanta nga studentët dhe diskutimi i tyre. Stafit akademik assiston apo ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë zhvillimit të mësimin apo praktikës mësimore.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese</p>	<p>Institucioni ka siguruar infrastrukturën mesimore të cilat bëjnë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional teorik. Përzhvillimin e praktikave laboratorike mësimore institucioni ka krijuar infrastrukturë laboratorike digjitale 3D e cila ju shërben studentëve për njohjen e metodave diagnostike bashkëkohore [RBV, takime stafin akademik, vizita në institucion].</p> <p>Stafit akademik për zhvillimin e procesit mësimor ofron mundësi të barabartë të gjithë studentëve pa diskriminim. Në rregulloren e UET parashikohen dhe</p>

<p>në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>metoda alternative të mesimdhënie dhe mesimnxeniepër studentët me nevoja të vecanta [takimi me stafin akademik, RBV, regullorja UET].</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni mbështet pedagogët për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe metodave të mesimdhënies, nëpërmjet mbështetjes për pjesmarje në program bashkëpunimi për shkëmbim eksperiencve midis IAL në kuadër të programeve Erasmus, konferenca shkencore, aktivitetet trainuese sipas shkallës së kualifikimit, përgatitje të projekteve dhe finacim të tyre me fonde të universitetit, përfshirjen e tyre në marveshje bashkëpunimi me institucione publike apo jo publike. Çdo vit UET organizon “staf development day” të cilat përfshijnë trainimin e stafit në metoda mesimdhënies, kërkimit, metodologjisë dhe projekteve. Në fillim të vitit akademik organizon trainimin dy ditor-back toëork-kthim në punë .</p>			
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mesimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Për ta bërë pjesën teorike të lëndëve sa më tërheqës për studentin institucionii mundëson stafi akademik përdorimin e metodave të ndryshme mesimdhënie si projektorët, prezantime pour point, metoda interaktive apo metodat online duke shfrytëzuar sistemin LSM që janë të përdorshme si për studentët dhe petagogët. Sic është theksuar edhe standartet e mësipërme IAL ka investuar në krijimin infrastrukturën e nevojshme laboratorike 3 D për demonstrimin e praktikave mësimore laboratorike.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mesimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgatitje profesionale, ekspertizën e duhur dhe eksperincë mjekësorë apo pedagogjike në lëndët që zhvillon. Institucioni ka të siguruar logjistikën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktivitetin kërkimor të studentëve etj] CV se stafit].</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Institucioni vlerëson në mënyrë periodike stafin akademik, procesin e mesimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësori të vlerësimit. [pyetësore me studentët]</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mesimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mesimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Për ta bërë pjesën teorike të lëndëve sa më tërheqës për studentin stafi akademik përdor metoda të ndryshme mesimdhënie si me anë të projektorëve, prezantime pour point, paraqitjen e materialeve audiovizive, metoda interaktive apo metodat online duke shfrytëzuar sistemin LSM që janë të përdorshme si për studentët dhe pedagogët, përfshirjen e studentëve në trainime dhe konferenca shkencore, apoprojekte sëbashku me pedagogët e tyre, organizmin e leksioneve të hapura me pedagogë dhe expert të jashtëm apo zhvillimine lëndëve “honorius course” të cilat bëhen dhe në gjuhën angleze. Gjatë procesit mësimor dhe praktikës mësimore studentët inkurajohen të punojnë në mënyrë të pavarurapo në grupe ku secili është angazhur në përgatitjen apo paraqitjen e një problemi të caktuar [takimi me stafin akademik dhe studentët].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	UET ka siguruar hapësira të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor të cilat janë të mjaftueshme, të pastra dhe të mirëmbajtura, të pajisura me sistem kondicionimi dhe ndriçimin e duhur. [vizita e ambienteve] Ambiente ku zhvillohet procesi mësimor kanë infrastrukturën fizike dhe logjistikë nevojshme, sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me kompjuter dhe projektorë për zhvillimin e mësimin, tabela shkrimi të cilat ndikojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies si dhe laboratorë mjekësorë mësimorë dixhital [vizita e ambienteve] .
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve burime të ndryshme informacioni si internet, referenca për literaturë në gjuhë të huaj në formë elektronike, sistemin online UMS dhe LMS ku ata mund të gjenë informacionin e nevojshëm për programin e studimit, leksionet, librat si dhe literaturën e nevojshme në gjuhën shqipe dhe të huaj.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Literatura bazë për programin e studimit gjendet në librarinë dhe bibliotekën e UET. Në fund të çdo syllabusi studenti gjen informacion lidhur me literaturën që mund të konsultojnë në gjuhën shqipe apo të huaj që i përgjigjet temave të programit mësimor. Për rastet kur mungon literatura ajo ju vihet në dispozicion nga pedagogu në formë elektronike. Literaturae vënë në dispozicion të studentëve është viteve të fundit. [format syllabusi [vizita e ambienteve, takime me stafin akademik dhe studentë] .
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.	Institucioni ka në funksion të studenteve dhe personelit akademik bibliotekën. <i>Gjatë vizitës në bibliotekë dhe takimet me stafin akademik GVJ konstatoi numrin e pakët të librave për infermierinë në gjuhën shqipe.</i> Krahas leksioneve të pedagogëve në dispozicion të studentëve FSHMT ka siguruar dhe literaturë në gjuhën angleze por jo të gjithë studentë mund të shfrytëzojnë literaturën e huaj. Institucioni publikon listën e librave të rinj që hyjnë në bibliotekë, oraret e shfrytëzimit të ambienteve të bibliotekës nga studentët apo stafi akademik biblioteka ka infrastrukturë të duhur dhe zotëron 150 poste leximi, 12 kompjutera, ambienti është i mbuluar me ëireles. [vizita e ambienteve ne institucion] .
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Institucioni i siguron Studentëve dhe pedagogëve mundësi aksesimi në

<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>librarinë online si burim informacioni sipas programit të studimit që ata frekuentojnë si dhe gjetjen e burimeve online të informacionit të gjetura nga vetë studentët apo stafi akademik. Burime ndërkomëbtare elektronike për libra apo artikuj shkencorë të siguruar nga UET janë EBCSO, emerald, CAMbridg university etj.</p> <p>Për mënyrën e përdorimit të sistemit online, institucioni ka dhe udhëzuesit përkatës në funksion të studentëve dhe stafit akademik.</p>			
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Institucioni ka në funksion të procesit mësimor, realizimit të detyrave të kursit apo temave të diplomës laboratorin mësimorë të informatikës/statistikës të paisura me kompjutera, videoprojektorë dhe foni. [vizita e ambieteve ne institucion, takimet me stafin].</p> <p>Në funksion të mësimdhënies janë platforma online UMS dhe LMS të aksesueshme për studentët dhe stafin akademik. Institucionimbështet dhe nxit përdorimin e tyre duke vënë në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve udhëzuesit përkatës për shfrytëzimin e tyre si dhe trainimin e studentëve dhe stafit akademik për përdorimin e tyre.</p>			
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Nga takimet me stafin, studentët, sekretarinë dhe burimet njerëzore, rezultoi se institucioni ka në përdorim sistemin e menaxhimi të informacionit, sekretarisë mësimore, burimeve njerëzore apo platformënë funksion të mësimdhënies on line dhe në distancë. [vizita e ambieteve ne institucion, takimet me stafin].</p>			
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Nga takimet me stafin, studentët, sekretarinë dhe burimet njerëzore, rezultoi se institucioni ka në përdorim sistemin e menaxhimi të informacionit, sekretarisë mësimore, burimeve njerëzore apo platformënë funksion të mësimdhënies on line dhe në distancë. [vizita e ambieteve ne institucion, takimet me stafin].</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Temat e diplomës zgjidhen nga studentët në konsultim me pedagogët e tyre në mënyrë që temat e tyre të janë lidhur me problematikat aktuale të sistemit shëndetësor, të jenë në funksion të përgatitjes së tyre profesionale dhe mundësive aktuale përrealizimin e pjesës eksperimentale të tyre. Institucioni ka një rregullore për procedure e zgjedhjes dhe miratimit të temës së diplomes dhe vleresimin e saj. [dokumenti punimit të diplomës dhe doktoraturës]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel</p>	<p>Institucioni ka të organizuar me akte rregullatore mënyren e funksionimit të UET/Fakulteteve/departamenteve të cilat janë në funksion të organizmit të</p>

<p>institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>mësimdhënies në programe të ndryshme që ka UET. Njësitë kryesore që asistojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencorë janë NJSBC dhe zyra e projekteve për Kërkim dhe Zhvillim përmes trajnimeve dhe projekteve të vazhdueshme ku përfshihet stafin akademik</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni kaKSBC e cila ështëpërgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional. Kjo njësi harton plan pune që miratohet nga Rektori i UET dhe e ndjek atë në vitin pasardhës. Në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, shërbejnë dhe leksionet e hapura të organizuar nga departamentet, pjesëmarrja e lektorëve të jashtëm nga fusha e biznesit, trajnimet periodike të stafit akademik. [rregullore KSBC, Plani i punës....].</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti i infermierisë dhe fizioterapise në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike është njësia përgjegjëse për realizimin e procesit mësimor dhe përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së tyre dhe përmirësimin e programit të mësimin në mastër shkencor në infermieri. Departamenti përcakton nevojat me staf akademik, përcakton kriteret për përzgjedhjen e tyre në procesin mësimor, bën shpërndarjen e ngarkesës mësimore sipas ekspertizës dhe kompetencës profesionale, miraton silabuset, monitoron realizimin e procesit mësimor sipas plani të miratuar, vlerëson procesin e mësimdhënies etj (Rregullorja e UET).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Njësia bazë ku zhvillohet ky program studimi mbështet dhe nxit pedagogët të përdorin metodave inovative dhe alternative në procesin e mësimdhënies. Hartimi i sylabuseve bëhet sipas një formati të miratuar ku një rubrikë e vecantë është prezantimi i metodës së mësimdhënies apo materialeve audivizive që duhet të zbatohen gjatë procesit mësimor, përzgjedhjen ee literaturës së nevojshme. Vetë institucioni organizaon tranime me stafin akademik për aspektet didaktike të mësimdhënies duke inkurajuar përdorimin e metodavë të ndryshme sipas tipologjisë së lëndës. Gjithë ky proces bazohet në rregulloret e UET dhe programit të studimit. [takimi me stafin akademik, regullorja e UET, rregullorja e programit të studimit].</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni nëpërmjet KSBC në bashkëpunim dhe njësitë bazë ku zhvillohen programe të ndryshme të studimit, siguron një program trajnimi për stafin akademik në përputhje me kualifikimin e tyre dhe gradën shkencore. Këtij qëllimi i shërbejnë aktivitetet si Staff Development Day – me qëllim trainimin e stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin, projektet dhe metodologjinë. Çdo vit në fillim të vitit akademik Universiteti organizon edhe trajnimin dy ditor me stafin akasemik “Back to ëork”. Gjithashtu, personeli akademik përfiton nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe njohur me praktikat e mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve apo përfshirjen në projekte kërkimore shkencore[lista e aktiviteteve, marveshjet].</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në</p>	

<p>mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Me qëllim përmirësimin e mësimdhënies nëpërmjet futjes së metodave të reja inovative në realizimin e procesit mësimor departamenti në bashkëpunim me departamentet e tjera organizojnë orë apo leksione të hapura apo trainime me stafin akademik, studentët dhe stafin ndihmës të angazhuar në realizimin e procesit mësimorë [takimi me drejtuesit e FSHMT dhe stafin].</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>	<p>Në zhvillimin e procesit mësimor duke u mbështetur në lirinë akademike pedagogu teston metoda të ndryshme mësimdhënie sipas lëndëve të vecanta sidomos pas rishikimit të sylabuseve kur kjo mund të jetë domosdoshmëri. Eksperiencat e reja diskutohen dhe rezultatet e tyre paraqiten në departament duke shpërndarë eksperiencës me kolegët. Këto i shërbejnë zbatimit të metodave të reja dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. [takimi me stafin drejtues dhe akademik].</p> <p>GVJ identifikoi se Institucioni mbështet angazhimin e personelit akademik në fushën e kërkimit shkencor duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në aktivitete shkencore, realizimit të konferencave të përbashkëta me IAL të tjera apo kompani biznesi, mbështetja me bursë për realizim të temave të doktoraturës në kuadër të projekteve të bashkëpunimit që kanë me institucione jashtë vendit, realizimin e botimeve në buletin shkencorë të fakultetit [takimi me stafin drejtues dhe akademik, revista e medicus, lista e aktiveve]</p> <p>Institucioni realizon takime apo konferenca të veçanta që shërbejnë për shkëmbim eksperience dhe shpërndarje të informacionit duke ftuar profesorë të huaj apo lektorë nga bota e biznesit. Këto aktivitete i shërbejnë përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencorë. Një eksperience e ndjekur në UET si dhe në këtë program studimi janë “Honours Course” ku pedagogët zhvillojnë leksione të hapura si pjesë e lëndëve integruese të kategoria C. Këto leksione kanë tematika të ndryshme në vite të ndryshme me specifikimet e programit. Shpesh këto leksione zhvillohen dhe në gjuhën angleze [takimi me stafin drejtues dhe akademik, planimësimor, lista e aktiveve].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.5</p>	
<p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumnetacionit të vënë në dispozicion dhe takimet e zhvilluar në institucion me studentët, pedagogë dhe stafin mbështetës konstatoi se vlerësimi i njohurive të studentëve dhe aftësive profesionale të stafit bazohen në rregulloret e institucionit miratuar nga rektori. Studentët njihen</p>

rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	me këto rregullore gjatë tureve orientim të studentëve si gjimnaz tour apo UET tour nga koordinatori e programit dhe zyra e kujdesit ndaj studentit, si dhe nga pedagogu i lëndës në fillim të sylabusit përkatës[takime me stafin, rregulloret e UET,programit të studimit].			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në sylabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të lëndës pedagogu prezanton sylabusin e lëndës, mënyrën e realizimit të procesit mësimor, tematikën e leksioneve, seminareve dhe praktikave laboratorike dhe orët mësimore përkatëse sipas ETC që ka lënda. Pedagogu informon studentit për mënyrë frekuentimit të procesit mësimor dhe vlerësim të dijeve. Frekuentimi i procesit mësimor është detyrueshëm në masën 80% të orëve. Vlerësimi i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme sipas rregullores së UET dhe rregullores së programit mësimor. Gjithë informacioni ju vihet në dispozicion studentëve në sistemin LMS[takime me stafin, rregulloret e UET,programit të studimit, sylabuset].			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	Vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale kryhet në mënyrë të vazhdueshme sipas tipologjisë së lëndëve dhe bazohet në nenin 5 të rregullores së programit të studimit [rregullorja e provimeve].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Institucioni zotëron të gjithëbazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimin e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe ju vihet këtyre të fundit në dispozicion në platformën LMS [rregulloret e funksionimit të UET dhe programit të studimit, rregullorja e provimeve] Vlerësimi i dijeve të studentit bëhet sipas rregullores së UET dhe rregullores së programit të studimit. Vlerësimi i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik me qëllim që të mundësojë studimin sistematik të studentit, të vlerësojë ecurinë e procesit mësimor dhe shkallën e asimilimit të lëndës nga studenti si dhe një vlerësim më objektiv të studentit duke e ndarë notën në disa komponentë dhe jo vetëm në provim përfundimtarë. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	

<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>në seminare Vlerësimi i dijeve bëhet në provim të ndërmjetëm, provim përfundimtarë, riprovimi dhe përnirësimit.</p> <p>Teza e provimit hartohet nga pedagogu i lëndës dhe përfshin 3 kategori pyetjesh si pyetje që kontrollojnë njohuritë 20%-30% të pyetjeve totale, 40-50% janë pyetje që kontrollojnë aftësitë analitike dhe pyetje që kërkojnë përqëndrim dhe arsyetim që janë ese, studim rasti ose ushtrime që përbëjnë 20-30% të tezës. Vlerësimi i dijeve bëhet sipas sistemit të pikëzimit dhe konvertimit në notë nga 4-10 sipa regullores së programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Nota përfundimtare bazohet në shumatoren e rezultateve që student mer gjatë gjith vitit akademik si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> Provimi i ndërmjetëm (30%) Niveli i diskutimit (10%) Detyrë kursit (ese, prezantime, projekte)/dy detyra praktike (20%) Provimi përfundimtar (40%).
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>[Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës (Neni 27 Provimet, rregullorja e programi të studimit)] Testimi i dijeve bëhet me shkrim dhe procesi i provimit bazohet në rregulloren e programit të studimit dhe është anonim në mënyrë që të shmanget abuzimi. [Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës (Neni 27 Provimet, rregullorja e programi të studimit)]</p> <p>Tesimi i dijeve përfundimtar realizohet nga pedagogu që ka zhvilluar lëndën. Procedura e kryerjes së provimit bazohet në rregulloren e programit të studimit. Studenti hyn në provim pasi ka kryer detyrimet e procesit mësimor për cdo lëndë dhe detyrimet financiare sipas kontratës që ka me institucionin.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Studenti paraqitet në provim me dokument identifikues dhe cdo objekt që ka me vete vendoset në një vënd të caktuar nga organizatorët. Në provim janë të pranishëm pedagogët e lëndës, kordinatori që kryhen sekretimin, monitorues nga departamenti dhe dekanati. GVJ nga verifikimi me sondazh i fletëve të provimit dhe takimi me përfaqësuesit e kurikulave konstatoi <i>se ka lëndë që provimi zhvillohet nga një pedagog dhe jo me komision të përbërë minimumi nga dy anëtarë [stand 3.6 kriteri 3]</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>[rregullorja e UET, programit të studimit, takimi me stafin akademik].</p> <p>Testimi i dijeve bëhet me shkrim, është anonim dhe me sekretim, pikët e vlerësimit vendosen në fletët e provimit nga pedagogu i lëndës dhe dorëzohen në sekretarinë mesimore e cila bën c' sekretimin. Vlerësimi i studentit me pikë është i detajuar për çdo pyetje dhe shënohet në fletën e provimit, me bojë dhe në tabelën përmbledhëse të vlerësimit të studentëve dhe firmoset nga pedagogu që ka bërë korrigjimin. Mbarëvajtja e provimit është përgjegjësi e sekretarisë/kordinatorit dhe komisionit të provimit [rregullorja e provimit].</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t' u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e</p>	<p>Vlerësimi i provimit ka si qëllim të vlerësoj dijet e përfuara nga studenti gjatë programit të studimit, ku ai duhet të përqëndrohet dhe të mësojë më tepër. Për</p>

<p>vlerësimit.</p> <p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>këtë qëllim vlerësimi i provimeve ka dhe komente sqaruese. Vlerësimi i dijeve duhet të stimulojë studentin dhe motivoj atë për të mësuar më shumë dhe jo ta penalizoj dhe demoralizoj atë[regullorja e provimit]..</p> <p>UET ka vendosur dhe zbaton që nga viti 2015një sistem elektronik antiplagjiaturë për të shmangur kopjimin në detyrat e kursit , punimet e diplomës apo doktoraturës. [takimi me stafin akademik, drejtues dhe RVB]</p> <p>Shkalla e përvetësimit të dijeve dhe aftësive profesionale me shkrim dhe / ose me gojë ose me temë diplome sipas rregulloreve të funksionimit të programit dhe në përputhje me specifikën e lëndës bëhet në bazë pikëzimi 0-100 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 deri në 10. Rezultatet e provimit ju komunikohen studentëve në kohë duke respektuar afatet ligjore të ërcaktuara në rregulloren e programit të studimit[regullorja e provimit, takime stafin].</p> <p>Student kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. procedura e shqyrtimit të ankesës përcaktohet në rregulloren e provimeve.</p> <p>Me rregulloren e zhvillimit të provimit studentët njihen paraprakisht nga pedagogu i lëndës. Student shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve [takimi me studentët, regullorja e provimit].</p> <p>Për çdo provim pasi studentët njihen me rezultatin, kanë të drejtë të kryejnë kërkesë me shkrim për rishikimin e notës sipas procedurës të miratuar në rregulloren përkatëse të provimit.</p> <p>Kërkesat për rishikim mbledhë shqyrtohen nga komisioni i vlerësimit të ngritur në rang departamenti. E gjithë procedura dokumentohet dhe arkivohet në institucion pranë Sekretarisë Mësimore, dhe në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm[takimi me studentët, rregullorja e provimit]..</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi III.7</p>	
<p>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Mastër shkencor infermieri është me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe ka 120 ECTS në total. Një vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor të ndarë në dy semestra. Një semestër ka 15 javë mësimore në auditor. 1 orë mësimore – 50 minuta. 1 ECTS = 25 orë punë studentit në auditor dhe ashtë auditorit. Procesi mësimor realizohet</p>

<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione seminare, praktika laboratorike, detyra kursi, apo prezantime apo praktika profesionale. Organizmi i programit mësimor si dhe kurikulat e programit/syllabuset/lëndët mësimorë mundësojnë formimin profesional të thelluuar dhe zhvillim të aftësive të veçanta si aftësi organizative, kërkim të pavarur shkencor, punën në grup etj[regullorja e programit,plani mësimor].</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Pjesë të programit mësimor përvec lëndëve të formit professional janë dhe ato të formit të përgjithshëm si metodat e kërkimit shkencor bazë dhe të avancuar[plani mësimor, kurikula e programit].</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Masteri shkencor në Infermieri synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara në profilin përkatës dhe të formojë infermierë me kompetencën e nevojshme profesionale teorike dhe praktike në fusha të specializuar të mjeksësisë për realizimin e misionit të infermierit në fushën përkatëse. Gjithashtu një element i rëndësishëm i programit është pajisja e tyre me njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe kërkimit për të cilën zhvillohet dhe një lëndë e vecantë në kurikulën e programit. Në përfundim të lëndëve të veçanta një vënd të rëndësishëm zë dhe diskutimi me studentët i përmbatjes së syllabuseve, sa ju ka shërbyer ky program studimi në formimin e tyre profesional, përfundim të aftësive dhe kompetencave në kryerjen e detyrave si dhe marrinmendimin dhe sygjerimet e studentëve për përmirësimin e programit të studimit. [kurikula e programit, takimi me studentët].</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në përfundim të lëndës pedagogu bën një përmbledhje të tematikave të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme orën e fundit të mësimit, pedagogu si dhe orienton studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin. Gjithashtu pedagogu ndalet në vecanti në temat që kanë më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës. Pedagogët i asistojnë studentët me konsultime me kërkues të studentët sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit gjatë orarit zyrtarë të punës[rregullorja e programit, takimi me stafin akademik dhe studentët].</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore institucioni organizon leksione të hapura, jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kane mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet tyre[lista e aktiviteteve].</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Në programi Master i Shkencave në infermieri janë angazhuar pedagogë me kualifikim dhe përvojë në mësimdhënie. Pjesa më e madhe e stafit që mbulon lëndët karakterizuese të kategorisë B, janë Mjekë specialistë të fushave përkatëse dhe kompetentë në këto fusha. Në lëndët e zhvilluar bazuar në CV e stafit akademik që u vunë në dispozicion, fusha e ekspertizës së pedagogut në përgjithësi përputhet me syllabusin e lëndës të cilën zhvillon pedagogu duke ndikuar në cilësinë e mësimdhënies. GVJ nga shqyrtimi i CV</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Në programi Master i Shkencave në infermieri janë angazhuar pedagogë me kualifikim dhe përvojë në mësimdhënie. Pjesa më e madhe e stafit që mbulon lëndët karakterizuese të kategorisë B, janë Mjekë specialistë të fushave përkatëse dhe kompetentë në këto fusha. Në lëndët e zhvilluar bazuar në CV e stafit akademik që u vunë në dispozicion, fusha e ekspertizës së pedagogut në përgjithësi përputhet me syllabusin e lëndës të cilën zhvillon pedagogu duke ndikuar në cilësinë e mësimdhënies. GVJ nga shqyrtimi i CV</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e</p>	<p>Në programi Master i Shkencave në infermieri janë angazhuar pedagogë me kualifikim dhe përvojë në mësimdhënie. Pjesa më e madhe e stafit që mbulon lëndët karakterizuese të kategorisë B, janë Mjekë specialistë të fushave përkatëse dhe kompetentë në këto fusha. Në lëndët e zhvilluar bazuar në CV e stafit akademik që u vunë në dispozicion, fusha e ekspertizës së pedagogut në përgjithësi përputhet me syllabusin e lëndës të cilën zhvillon pedagogu duke ndikuar në cilësinë e mësimdhënies. GVJ nga shqyrtimi i CV</p>

shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	- ve stafit konstatoi se ka lëndë nga pedagogë që ekspertiza dhe formimi profesional nuk përputhen me lëndën që ato zhvillojnë psh pedagog me formim në biologji zhvillojnë lëndë mjekësore si mikrobiologji, biokimi mjekësore, mjeksi laboratorike [Cv e stafit akademik].			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	<p>Një ndër mënyrat që motivon studentët në asimilimin e programit mësimor është dhe puna e pavarur e studentit, puna në grup gjatë seminare apo aktivitetve trainuese të cila ju mundësojnë studentëve aftësitë organizuese dhe drejtuese , komunikimit me etike midis kolegëve[takimi me studentë].</p> <p>Në zhvillimin e procesit mësimor liria akademike që siguron institucioni, ju mundeson pedagogëve përdorimin e metodave në ndryshme në mësimdhënie, në punimin e temave të dilomës, gjatë studimeve të doktoraturës[takim me stafin akademi].</p> <p>Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentë në bashkëpunim me pedagogët. Këtij qëllimi i shërbejnë angazhimi që UET ka me programet Erasmus + për mobilitetin e studentëve dhe të stafeve akademike, projekte e bashkëpunimit me IALtë tjera brënda dhe jashtë vëndit [lista e projekteve dhe bashkëpunimeve]</p> <p>Programi Master i Shkencave në infermieri ka patur shkëmbime eksperiencia në kuadër të marrveshjes me universitetin Cordova 2019-2021 të financuar nga Erasmus+. FSHMT është në proces nënshkrimi i draft marrveshjes me qëndrën Tirol në austri në bazë të të cilës 3 studentë të këtij program do kryejnë praktikë 5-8 javë në këtë institucion. Duke qënë se FSHMT është fakultet I ri në UET po mbështetet nga zyra e projekteve për të aplikuar në thirjet e reja të Erasmus plus për 2021 në tetor. Gjithashtu në kuadër të shkëmbimeve të personelit akademik në universitetet partnere perëndimore në kuadër të programeve Erasmus + KA1 një pedagoge e FSHMT ka qënë në universitetin të Poloni për të dhënë mësim dhe leksione në shkecat mjekësore. Këto bashkëpunime mundësojnë rritjen e shkëmbimit të eksperiencës dhe përfitimin prej praktikave më të mira, të cilat më tej përshkatan nga personeli akademik pas rikthimit në UET duke u shpërndarë dhe tek kolegët e tjerë në institucion[plani I projekteve dhe marrveshjet].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Studenti me përfundimin e studimeve pajiset me diplome Mastër shkencor në në infermieri,” pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka mbrojtur mikrotezën. Rregullorja e punimit të temës së diplomës mbart informacione të detajuara për mënyrën e shkrimi të temës së diplomës. Proçedura e provimit përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës bazohet në rregulloren e UET dhe të programit të studimit. Komisioni vlerësimi ngrihet në bazë departamenti dhe përbëhet nga 5 anëtarë.[rregullorja e diplomimit, rregullorja e punimit të diplomës].</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Fokusi i programit Mastër shkencor në infermieri,” është përvetësimi i aftësive praktike profesionale dhe kompetencave në ushtrimin e profesionit nga ana e studentit. Bazuar në këtë qëllim provimi përfundimtar si detyrë përfundimtar, synon të testojë aftësitë e studentëve për të aplikuar njohuritë e përfituara në programin e studimit në përgatitjen e një teme diplome. Studentët asistohen nga pedagogët e programit të studimit për provimin përfundimtarë dhe në zgjedhjen e temës së diplomës. Në përfundim të lëndës studentët orientohen nga pedagogët duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin si dhe literaturëm që do të shfrytëzohen. Gjithashtu, pedagogët i asistojnë studentët me konsultime me kërkesë të studentët sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit gjatë orarit zyrtarë të punës.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Temat propozohen nga departamenti dhe lista e tematikave të propozuara i paraqiten studentëve dhe udhëheqësve të tyre. Zgjedhja e temës e cila ka karakter aplikativ/praktikë bëhet nga student dhe pedagogu udhëheqës [punimi I diplomës, rregullorja UET].</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Në provimin përfundimtar çdo lëndë ka një peshë specifike dhe përfshihet me pyetje të vecanta ose një rast klinik apo praktik që duhet të zgjidhet nga studentit gjatë kohës së provimit. Ky studim lidhet ngushtë me profilin që ka studjuar studentit dhe njohuritë që ai ka përfutuar në këtë program studimi. Mënyra e vlerësimit përcaktohet nga komisioni provimit i cili përbëhet nga pedagogë që kanë zhvilluar lëndët e programit mësimor pedagogët e komisionit [rregullorja programit]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Përcaktimi i temave të diplomës bëhet nga departamenti ku zhvillohet programi studimit, në fillim të vitit të dytë akademik. Temat përcaktohen nga pedagogët pas zhvillimit të takimit me bordin e tregut të punës në departament, ku diskutohen tematika të ndryshme të cilat mund të shërbejnë dhe si tema diplome si dhe identifikohen pedagogët që mund të udhëheqin diplomat. Temat e diplomës caktohen në fillim të vit akademik dhe jo më vonë se java 5 e semestrit të parë. Formulari i plotësuar nga studentit paraqitet në sekretarinë mësimore. Studentët asistohen nga pedagogët dhe stafi sekretarisë në caktimin e temës së diplomës, zgjedhjen e udhëheqësit dhe plotësimi e formularit të aplikimit për temën e diplomës. Aplikimet shqyrtohen në departament dhe miratohen nga dekani brenda datës 15 dhjetor.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në realizimin e temës së diplomës studentët asistohen nga pedagogët ndihma e</p>

<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>të cilëve konsiston në zhvillimin e seancave metodologjike që janë orë pune që ndihmojnë studentin në hartimin e strukturës së temës, zgjedhjen e literaturës, metodologjinë e hartimit, shkrimit apo prezantim e punimit të diplomës. Seancat metodologjike zhvillohen nga pedagogu udhëheqës i temës dhe kanë karakter interaktiv. Frekuentimi i këtyre seancave është i detyrueshëm në masën 60%.</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve për realizmin e pjesës teoriketë temës së diplomës infrastrukturën e nevojshme si dhe ju garanton studentëve mbledhjen e të dhënave apo realizimin e testeve të ndryshmenë funksion të temës në institucionet shëndetësore me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi [infrastruktura, marrëveshjet e bashkëpunimit kombëtare, takimi me stafin akademik].</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Pedagogu udhëheqës udhëzon dhe orienton studentin gjatë punimit të temës, mbledhjen e të dhënave dhe përpunimin e rezultateve, literaturën që do shfrytëzoj dhe jep miratimin me shkrim nëse studimi është i plotë për tu paraqitur përpara komisionit të vlerësimit [regullorja e diplomës, Rregullorja UET].</p>
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen</p>	<p>Mbrojtja e temës së diplomës bëhet përpara komisioni të propozuar nga departamenti dhe miratuar nga Dekani i fakultetit. Provimi përfundimtar dhe punimi i diplomës vlerësohen nga komisioni me notë, e cila është mesatare e vlerësimit të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit.</p> <p>Rezultati përfundimtar shënohet në Procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve. Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Diplomave është përfundimtar dhe nuk mund të ankimohet.</p> <p>Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së temës së diplomës bazohet në Dokumentin BII mbi punimin e temës së diplomës dhe dizertacionit.</p> <p>Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj UET-it dhe ka përmbushur detyrimet përmbyllëse të programit të studimit, pajiset nga institucioni me diplomën përkatëse, të shoqëruar me certifikatën e notave të marra gjatë studimeve universitare në UET, me suplementin e diplomës, të firmosura nga Dekani dhe Sekretari i Përgjithshëm brenda 6 (gjashtë) muajsh. Deri në pajisjen me diplomë të të diplomuarve, UET-i lëshon një vërtetim për diplomën e fituar, të shoqëruar me certifikatën e notave.</p> <p>Në përfundim të studimeve në këtë program studentit pajisjet dhe me një kopje të programit të studimit që ka zhvilluar në cikline dytë të studimeve në Mastër shkencor në Infermieri. [programi i studimit]</p> <p>Dokumentacioni lidhur me studentët ruhen ngaj institucioni për një afat kohor të pacaktuar dhe mund të jap informacion për studentët nëse kërkohet</p> <p>Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore</p>

	sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, ASCAL [rregullore e sistemit të menaxhimit].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR
REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësitor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem GVJ konstatoi se UET disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit “Master i Shkencave “ në Infermieri . Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore në dosjet personale të stafit akademik e cila mban evidencë edhe për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër. [dokumentacioni i verifikuar në mënyrë rastësore].</p> <p>Institucioni ka vënë në dispozicion listën e personelit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe ngarkesën e tyre mësimore.</p> <p>Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore u përzgjedhën dy dosje në mënyrë rastësore, një nga personeli akademik efektiv dhe një me kontratë të cilat rezultuan të kompletuara konform rregullave dhe kriterëve institucionale.</p> <p><i>GVJ evendoj që disa anëtarë të stafit akademik PAE të Departamentit Infermieri dhe Imazherideklarojnë në CVqë janë të punësuar me kohë të plotë në një institucion shtetëror.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore të institucionit GVJ u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK. GVJ verifikoi dosjet e personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Institucioni disponon rregullore në lidhje me kriteret e kandidatëve dhe procedurën e rekrutimit të miratuar nga UET (Rregullore për Burimet Njerëzore Ref 11).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe</p>	<p>Rekrutimi i stafit kryhet sipas akteve rregullatore të miratuar nga UET në cilat përcaktohen qartësi të gjitha fazat , që nga evidentimi i nevojës të cdo departamenti nga përgjegjësit e departamenteve, aprovimi nga dekani dhe rektori, përcaktimi dhe shpallja e kriterive, i kriterëve. Rekrutimi i stafit akademik si efektiv ashtu dhe me kontratë bëhet me konkurs. Për cdo vend vakant njoftimet behen në faqen zyrtare të Institucionit, rrjetet sociale (shembull thirrje për staf akademik).</p> <p>Në diskutimin me pedagogët u konstatua se ata njihen paraprakisht me të</p>

përmbajtjen e programit të studimit	drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës. Vlerësimi i stafit akademik zhvillohet si në momentin e rekrutimit ashtu edhe në vijim. Këto procedura janë të përcaktuara në dokumentet e brendshme të institucionit UET (Rregullore për Burimet Njerëzore) <i>Përzgjedhja e stafit bëhet jo vetem duke marrë në konsideratë nevojat institucionle por edhe ekspertizën e kandidatëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	UETka siguar kushtet dhe hapësirat, infrastrukturën fizike dhe logjistike për stafin eme qëllim kryerjen detyrave në procesin mësimdhënës dhe shkencor [Dok 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit]. Zyrat janë të mirëpajisura me kompjutera, kanë ndricim dhe sisteme kondicionimi. (vizita e ambjenteve). Institucioni boton revistë shkencore (Revista Medicus e specializuar në fushën e shkencave mjekësore) dhe gjithashtu ka organizuar disa aktivitete në mbështetje të zhvillimit profesional të stafit (Të dhëna mbi projektet, shkembimet, publikimet dhe veprimtaria shkencore e stafit akademik) <i>por GVJ konstaton se numri i këtyre aktiviteteve është minimal, ndoshta e diktuar dhe nga situata e pandemisë, në këto kushte ne rekomandojmë shtimin e aktiviteteve shkencore si konferenca, symposiume etj. të dedikuara në fushën e mjekësisë në përgjithësi dhe atë të infermieristikës në vecanti.</i>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Nga takimi me personelin akademik, personeli akademik shprehet se Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të tyre. [takimi me personelin akademik]. GVJ evidenton që personeli akademik i cilimbulon programin e studimit, ka një aktivitet shkencor të pasur si në botime shkencore ashtu dhe në prezantime në aktivitete të ndryshme të shkencave mjekësore, por këto aktivitete janë produkt më tepër të investuar personalisht sesa kontributin e institucionit.
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësues-shkencor.	Ne RVB theksohet se institucioni është përfshirë në një sërë projektesh, të financuara nga donatorë të ndryshëm, dhe me partnerë nga vendet e BE-së dhe rajoni, GVJ evidenton se Institucioni ka lidhur marrveshje bashkepunimi me Cordoba University 2019-2021 dhe është në finalizim marrveshja me Qëndrën
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të	

programit të studimeve të ciklit të dytë	<p>shëndetsore Tirol Austri.</p> <p>UET ka ndërtuar skemën e financimit të kërkimit shkencor, duke krijuar një fond prej 75.000 Euro për stafin që boton artikuj në revista shkencore të indeksuara në Thomson Reuters. Nisma më e fundit e UET është krijimi i një Grupi Kërkimi Ndërdisciplinor prej 10 profesorësh të disiplinave të ndryshme, të cilëve iu është akorduar një fond vjetor për kërkim shkencor, prej 5.000 euro/secili.</p> <p>Instucioni ofron trajnime të shkurtra për të rritur aftësinë e stafit akademik për të ndërmarrë punë kërkimore të pavarurme qëllim botimin në revista shkencore me faktor ipakti.Trajnime gjatë kësaj periudhe janë kryer edhe nga Zyra e TIK , për përdorimin e sistemeve informatike në funksion të dixhitalizimit të mësimdhenies.</p> <p><i>GVJ rekomandon që institucioni të vazhdojë angazhimit e tij më qëllim krijimin e mundësive konkretëpër kualifikimin e vazhdueshëm dhe krijimin e mundësivë për zhvillimin shkencor të personelit akademik i cili mbulon shkencat mjekësore në përgjithësi dhe programin në vecanti</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhenës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhenëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Mjediset, infrastruktura, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësormësimor.</p> <p>Në dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura e nevojshme sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimore, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin, bibliotekë si dhe hapësirë të jashtme nëambiente të tjera dhe parking.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik</p>	<p>Ambjentet janëme sistem kondicionimi dhe sistem ëireless,nyjehidrosanitare, sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit, sistem sigurie dhe vëzhgimi të ambienteve të cilat u verifikuan dhe gjatë vizitës në institucion. GVJ vizitoi auditorët mësimorë ku sallat e leksioneve te organizuara ne forme amfiteatriushin të pajisura me video- projektor, kompjuter të lidhur me internet, tabela dhe foni.Pajisjet e mjediseve</p>

e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënien në përputhje me qëllimet e programit. [vizita e ambienteve]			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Institucioni disponon 10 salla leksionesh, 14 salla seminaresh, 5 laboratore mesimore informatike të paisura me softëare përkates në funksion të cdo programi mesimor dhe me video projektor. Të gjitha sallat mesimore janë të paisura gjithashtu me mjete audio vizive si PC, projektorë			
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Ndriçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore. Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ekzistojnë ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	<p><i>Institucioni dispononte laboratorë mësimore mjekësore dhe kabine të infermieristike në funksion direkt të zhvillimit të programit mesimor të cilët ishin të mirë paisur. Institucioni si rezultat i fitimit të financimit nga projekte të ERASMUS + kandërtuar laboratore mjekësore duke u bazuar nënjë teknologjie të lartë 3 dimensionale virtuale, duke rritur në këtë mënyrë cilësinë e zhvillimit të orëve laboratorike dhe praktike në këtë program studimi.</i></p> <p>Për kryerjen e orëve të praktikës profesionale sipas programit të studimit UET përcakton procedura të detajuar të aplikimit, realizimit, ndjekjes dhe vlerësimit. UET ka marrëveshje bashkëpunimi me QSUT, Spitalin i Traumës, Spitalin Amerikan dhe disa institucione të tjera shëndetsore private. (marrëveshje bashkëpunimi UET)</p> <p><i>GVJ vë re që shumica e studenteve nuk e kanë kryer praktikën mesimorë në këto institucione por në institucione të tjera shëndetsore pranë vendeve të banimit, diktuar kjo nga stuata e pandemië, me të cilat UET nuk ka marrëveshje të dokumentuar bashkëpunimi. GVJ rekomandon dokumentimin e këtyre bashkëpunimeve dhe me institucione të tjera shëndetsore jashtë Tiranës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e	Biblioteka e institucionit ka një sipërfaqe 300m ² dheka gjithsej 150 vende leximi, 14 kompjutera dhe gjithë ambjenti është i mbuluar nga rrjetet e internetit, duke siguruar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të

shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	barabartë nga studentët e programit të studimit.			
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	Biblioteka ka krijuar një Katalog me libra elektronik në gjuhë të huaj, icilikaqindratitujlibrashnëbazëtëprogramevetëstudimit dhe që u vjen në ndihmë studentëve të të gjitha niveleve të studimit. Studentën mund të zhfrytësojnë literaturën fizike e cila apurohet cdo vit në bazë të kërkesave nga stafi akademik,katalogut të të librave elektronike të krijuar nga biblioteka,aksesit në libraritë elektronike. <i>Gjatë vizitës në bibliotekëGVJ evidentoi që literatura fizike në funksion të programit ishte kufizuar.Literatura në gjuhën shqipe është minimale, panvarësisht numrit të lartë të titujve në formë elektronike mundësia e shfrytëzimit të tyre nga studentët është e kufizuar pasi shumica e këtyre titujve nuk përbëjnë literature bazë studimore dhe janë në gjuhë të huaj,dhe në takimin me studentët u vu re një interes i pakët ityre për shfrytësimin ebibliotekës si fizikish ashtu dhe on line.</i>			
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	<i>Institucioni nuk kishte siguruar leksione të shkruara / të printuara për programe studimit për të kompesuar mungesën e literaturës në gjuhën shqipe.</i>			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Bibliotekakasiguruaraksesnëburimendërkombëtareelektronike për artikuj dhe libra shkencorë si:SAGE, EBSCO dhe Questia.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Biblioteka është e pajisur me poste internet, me kompjutera që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëveshfrytëzimin e literaturës së nevojshme për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjatë vizitës në institucionu evidentua se institucioni zbatonte plane të detajuara në lidhje me procedurat e shtimit të titujve ne biblioteke me qellim pasuriminiliteraturë mjekësore bashkëkohore. (Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë (Ref.Nr.45.2)			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Bibliotekaështë në funksion të programit mësimor si për student dhe pedagogët. Gjatë vizitës nëinstitucion GVJ u identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara dhe janë në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. nga e Hënë-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00:17:00. Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: nga e Hënë-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00-17:00. Ndërsa gjatë sezonit të provimeve është e hapurme orar të zgjatur.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	




Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UET disponon sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, sistemin UMSI (Manual i përdoruesit të sistemit UMIS) . Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit. Një nga funksionet kryesore të UMIS është: Sistemi i Menaxhimit të Studentit, i cili përmban informacionin personal të studentit, regjistrimin e notave, adresat e tyre, informimin për aktivitete të ndryshme etj.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i brendshëm UMIS shërben edhe për administrimin e informacionit në lidhje me aktivitetin akademik të stafit dhe personelit administrativ. Institucioni ka vënë në dispozicion të studenteve dhe stafit të angazhuar në program, sistemin e menaxhimit të mësimdhënies online LMS, studentët dhe pedagogët në këtë sistem kanë akses të dedikuar në lëndët dhe informacionet që u takojnë. Sistemi mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemin nga studentët.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	UET në funksion të dixhitalizimit të procesit të mësimdhënies ka ndërtuar Sistemin Menaxhimit të Mësimdhënies UET LMS Ky sistem ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues, student apo pedagog duke lehtësuar komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit dhe informacionit mes pedagogut dhe studentëve dhe kontribuuar në rritjen e cilësisë së mësimdhënies.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Në sistem janë të regjistruar të gjithë studentet në lëndët përkatëse duke pasur akses të dedikuar në bazë të programit që ndjekin. Të gjithë pedagogët kanë akses të dedikuar gjithashtu, ata mund të menaxhojnë vetë të gjithë procesin e mësimdhënies, duke filluar nga percaktimi i detyrave të kursit realizimi i vlerësimeve zhvillimi i firmave diskutimeve etj.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Platforma LMS (Learning Management System) funksionon si një mjet eficient në dispozicion të organeve drejtuese dhe titullarët, për të monitoruar në kohë reale mbarëvajtjen e procesit të akademik dhe administrativ dhe për të gjeneruar të dhëna statistikore. Faqja Zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës (UET) në web është: www.uet.edu.al . Faqja zyrtare përmban informacion kryesor në lidhje me Universitetin: misionin, drejtimin, funksionimin dhe organizimin. Faqja zyrtare jep informacion mbi fakultetet, kërkimin shkencor, botimet e UET-
Kriteri 6. Informacionet që	

lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Press-it si dhe shërbime të tjera që ofrohen nga UET-i. Faqja zyrtare përmban informacion të plotë mbi guidat për studentët e ardhshëm të Universitetit si dhe mbi programet dhe sylabuset e lëndëve. Faqja zyrtare në web është në gjuhën shqipe dhe angleze.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ nuk ka dispozicion dokumentacion në lidhje me menyrën e administrimit financiar të institucionit, në RVB deklarohet se Buxheti financiar hartohet në muajin tetor të çdo viti dhe për zbatim tëkëtij buxheti, ngarkohet Administratori dhe Zyra e Financës. <i>GVJ nuk iu vunë në dispozicion të dhëna mbi procedurën e hartimit të buxhetit, alokimin dhe realizimin e tij në nivel institucional dhe të programit të studimit.</i> <i>GVJ nuk iu vunë në dispozicion raporte financiare në bazë institucion apo në bazë programi.</i> Në RVB deklarohet se keto raporte hartohen vetem në rang institucioni. Dokumentet e vetme që janë vënë në dispozicion janë : dok 50 Të ardhurat nga financime të ndryshëm dhe dok 49 të dhëna për koston e studenteve, ku nuk cilësohet kostoja e studentëve në programin përktës. <i>GVJ nuk ka të dhëna në lidhje me shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor a shpenzime të tjera në funksion të realizimit të programit.</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas	Institucioni deklaron se kryen auditin të pasqyrave financiare të përvitshëm, dhe çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. <i>Në dispozicion të GVJ janë vendosur pasqyra dhe raporte financiare por jo raporte auditimi.</i> Në RVB, informacioni mbi analizën financiare për mbarëvajtjen dhe ecurinë e programit të studimit është jo i plotë. UET është një institucion privat i arsimit të lartë dhe si i tillë ai financohet nga burimet e tij të brendshme të financimit. Në dokumentet shoqëruese deklarohet se burime të financimit janë tarifrat e studentëve (regjistrimit dhe shkollimit) , grantet për kërkim dhe aktivitetet

natyrës specifike të tij.	tregtare (qeradhenie, parkim etj.). GVJ nuk identifikoi analiza mbi të cilat të jenë hartuar politika apo ndërhyrjet e posaçme në buxhet për diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij për vitet në vijim.			
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	<i>Në RVBdeklarohet se institucioni ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitete të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare, të dhënat që na janë ofruar na bëjnë të dalim në konkluzionin që momentalisht institucioni ka qëndrueshmëri financiare, por GVJ nuk mund të dali në një konkluzion të saktë në lidhje me garantimin e një ecurie afatgjatë të institucionit dhe programit të studimit në veçanti.</i>			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.				
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	UET është institucion jo publik i cili bazon aktivitetin e vet në bazën ligjore aktuale në fuqi. Në bazë të nenit 13 të Rregullores mbi “ Formën e studimit” institucioni ofron programe studimi në bazë të legjilacionit në fuqi. Institucioni disponon akte rregullatore për strukturat dhe njësitë kryesore në përputhje me statutin dhe rregulloren. Edhe për administrimin e studentëve nga regjistrimi deri në diplomim, në këto akte janë parashikuar procedurat e regjistrimit, mësimdhënies, transferimit, vlerësimit dhe diplomimit. (dok. Mbi politikat ,kriteret dhe proceset e pranimit të studenteve. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit)
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Në rregulloren mësimore të MSH pohon se përzgjedhja e kandidatëve bazohet në parimet e barazisë, të drejtësisë, të paanësisë dhe të meritës (Referuar , Pranimit në programin e studimit, Rregullorja mësimore MSH).
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në fazat e regjistrimit, institucioni ndjek procedurën e publikimit on line të kriterëve , publikimit të broshurës informuese (Guida UET), fushatave informuese mediatike, duke dhënë informacione të sakta dhe transparente në lidhje me procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve [Rregullore UET, Neni 42]. Kriteret dhe procedurat gjithashtu ibëhentëditurat të interesuarve gjatë vizitës në institucion, institucionin ndjek ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit duke zbatuar dhe ndjekur aktet rregullator të cilat i vihen në dispozicion studentëve. (Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin, ref 28. Mbi funksionimin e zyrës së karrierës dhe kujdest ndaj studentit .Ref nr. 12.)
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të dhe aksesueshme on-line, dhe janë përcaktuar në bazë të nenit 35 të Rregullores së UET, mbi pranimit, transferimet, njohjen e studimeve të mëparshme, diplomimit dhe mobilitetin të studenteve.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të	Numri i studenteve që ndjekin këtë program studimi është më i vogël se kuotat, program është i ri dhe institucioni nuk ka përcaktuar kriteret të veçanta për pranimit. Kështu politika e pranimit të studentëve në këtë program studimi është bazuar Ligjin e Arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore. Sipas të dhënave të sekretarisë në këtë program studimi numri i studentëve është si më poshtë:

programit të studimit	<p>2018-2019- 1 studente(e diplomuar)</p> <p>2019-2020-5 studente(4 ne process dhe 1 diplomuar (transferim))</p> <p>20-21-13 studente</p> <p>Gjatë vizitës në institucion na u bë me dije se politikat e pranimit të studentëve ne MSH do të vijnë duke u konsoliduar duke u vendosur edhe kriteret specifike në pranimin e studentëve</p> <p>Informacioninë lidhje me kurrikulat dhe programet që institucioni ofron vihet në dispozicion të publikut dhe shpërndahetpërmesrrugëvetendryshmetëkomunikimit.</p> <p>Gjithashtu në kuadër të fillimit të vitit të ri akademik, UET zhvillon Javën e Orientimit me qëllim njohjen e studentëve të rinjme programet, pedagogët, ambientet dhe rregullat bazë të universitetit. (Dok. Komunikimi i integruar i marketingut, Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Institucioni informon studentët në lidhje me procedurat e pranimit. Ato janë publike dhe të aksesueshme nga të gjithë. Programi i studimit zgjat dy viteakademike dhe institucioni ka vënë në dispozicion informacionin për kriteret e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. (Rregullorja e UET neni 23 mbi sistemin e vlerësimit dhe neni 29 mbi kalimin në vitin pasardhës)</p> <p>Në rregulloren eUET Kreu VII,janë evidentuarkriteret dhe procedurate njohjes se kualifikimeve të mëparshme dhe modalitetet e transferimitnga shkolla të tjera universitare dhe njëkohësisht modalitetet e transferimit te studenteve te UET drejt shkollave të tjera universitare. UET pranon transferime nga shkolla të tjera universitare,vendase apo të huaja.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.</p>	<p>Institucioni në fillim të vitit akademik, përmes koordinatorës së departamentitinformon studentët modalitet e përmbylljes sësyllabusit pjesë e të cilit është, dhe gjithashtu për mënyrën dhe kriteret e vlerësimit të dijeve në programin e studimit. (Rregullore e programit të studimit_MSH</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në</p>	

programin e studimit.	nëInfermieri).			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.Modalitet përkatëse, si plani i diplomimitin qënga momenti i aplikimit, miratimin e temës dhe pedagogun udhëheqës të Departamentit, e derinëdorëzimin dhe mbrojtjen janë të dokumentuara. (Dokumenti B.II Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit)			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Institucioni zhvillon OPEN DAYS ku aspirantët për studentë në këtë institucion mund ta vizitojnë nga afër , të marrin pjesë në procesin mesimor të njihen me ambjentët etj. Gjithashtu UET nëfillimit të vitit të ri akademik, zhvillon Javën e Orientimit më qëllim njohjen e studentëve të rinjme programet, pedagogët, ambjentet dhe rregullat bazë të universitetit. (Dok Komunikimi i integruar i marketingut, Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët e programit të studimitnë lidhje me strukturë,organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit , informohen përmes: <ul style="list-style-type: none"> • Kontakteve mestafin akademik, • Kontakteve me Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit • Rregullores mësimore të programit të studimit (takimi me studentët).
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Programi i studimit dhe plani mësimor përmbajnë informacionin me kohëzgjatjen e studimeve dhe ngarkesën në orë dhe kredite [programi], [plani mësimor] UET ve në dispozicion të studentëve informacione dhe dokumente për zhvillimin e lëndëve/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, këto programe u dërgohen elektronikisht nga koordinatorja e departamentit dhe gjenten ne forme hard copy në bibliatekën e institucionit. . Syllabuset dhe materialet e leximit për secilën lëndë hidhen edhe në sistemin
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt	

dhe në tregun e punës.	LMS (Learning Managment System).			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Të dhënat e detajuara për programin e studimeve gjenden edhe në faqen e internetit të universitetit www.uet.edu.al (verifikuar nga GVJ). Shumica e studenteve të këtij program studimi ishin në marrëdhënie pune në institucione të ndryshme shëndetësore. Mbi mundësitë e punësimit të tyre, institucioni i orienton përmes zyrës së karrierës, bordeve të tregut të punës dhe organizimit të panairit të punës, dërgimit të njoftimeve në lidhje me mundësitë e punësimit. (Dok Bordi i Tregut të Punës 2018-2019, Dita e Biznesit në UET ; http://uet.edu.al/neë/dita-e-biznesit-ne-uet/ ; http://uet.edu.al/neë/edukimi-financiar-sa-te-informuar-jane-te-rinjte-sot/GVJ rekomandon që institucionitë asistojë studentët pas diplomimit të tyre, në të gjitha veprimtaritë jashtë kurrikulare dhe të punësimit me qëllim jo vetëm integrimin e tyre të shpejtë të tyre në tregun e punës por dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm akademik dhe profesional.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Gjatë takimit me student GVJ vuri re entuziazëm, synime të qarta për karrierën e tyre dhe arsye konkrete për zgjedhjen dhe ndjekjen e këtij program studimi.			
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Institucioni përmes koordinatorës së departamentit mban kontakte të rregullta me studentët që ndjekin programet e studimit të Departamentit duke i përditësuar mbi zhvillim, organizimin e procesit mësimor dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Informacionet përcillen përmes telefonatave, email dhe sistemit LMS. Sistemi i menaxhimit të brendshëm LMS i cili disponohet nga institucioni lehtëson komunikimin me studentet në lidhje me programin e studimit dhe kurata janë në distancë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve në programin e	Institucioni disponon të dhëna në lidhje me numrin e studenteve të regjistruar dhe diplomuar në programin e studimit, duke qenë se programi MSH në infermierinë është një program i ri dhe ka vetëm një student të diplomuar, të dhënat janë për cilësinë në hyrje të studentëve dhe

studimit.	informacioni është mbi punësimin aktual të tyre [vizita në IAL]			
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Institucioni disponon të dhëna në lidhje me studentët e regjistruar, studentët me bursë, studentët e transferuar, ata që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër, ata që janë çregjistruar, si edhe studentët e diplomuar për secilin program studimi. Në programin e MSH në infermieri GVJ evidenton se deri më tani nuk raste studentësh të cilët kanë ndërprerë studimet. Nga verifikimi i dokumentacionit në letër (hard -copy), GVJ nuk identifikoi ndonjë pasaktësi që lidhen me mungesa në dokumentacion, mungesë të numrit të matricullimit apo pasaktësi në plotësimin e regjistrimit themeltar.			
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Institucioni arkivon rregullisht të gjitha rezultatet e të nxenit. Procesverbalet e provimeve ruhen në sekretarinë mësimore. <i>Provimet dhe testimet, institucioni deklaron se realizohen me komisione por GVJ identifikoi raste ku procesverbalet ishin të firmosura vetëm nga një anëtar.</i>			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Në programin MSH në Infermieri, janë të regjistruar për vitin akademik 2018-2019: 1 student ; 2019-2020 5 studente ; 2020- 2021 : 13 studente Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre. Verifikuar gjatë vizitës në IAL. Institucioni disponon Sistemin e menaxhimit të Informacionit UMIS i cili mundëson ruajtjen, menaxhimin dhe aksesin e të dhënave për personat e autorizuar.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Institucioni deklaron se meqënëse, Programi MSH në Infermieri është një programi , hartimi i një raport analitik mbi cilësinë në dalje dhe shkallën e punësimit është në proces, praktikë e ndjekur dhe për programe të tjera. <i>GVJ rekomandon përpilimin e raportit analitik për këta studente me qëllim evidentimin e problemeve në cilësinë e daljes, punësimin dhe marrjen e masave të duhura për përmirësimin e treguesve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në dokumentet kryesore të institucionit (statuti, rregullorja e përgjithshme etj), studentët janë të përfshirë në strukturat vendimmarrëse të UET. Strukturat kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Këshilli i Studentëve-realizon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese. • Senati Akademik –ka përfaqësues të studentëve. • Këshilli Etikës - një anëtar i rekomandohet Rektorit nga Këshilli i Studentëve. • KSBC – ka një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve. • Mbledhjet e departamenteve, një në muaj është e hapur për studentët. <p>Përfshirja e studentëve në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik është e mundur bazuar në aktet rregullatore por gjithashtu mundësohet edhe përmes zhvillimit të fokus grupeve, pyetsoreve on line, shqyrtimit dhe plotësimit të kërkesave të studentëve. Këto të dhëna mblidhen dhe adresohen për zgjidhje dhe përmirësim. (takimi me studentët). Një student i programit MSH në infermieri është dhe pjesë e GVB e cili ka hartuar RVB.</p> <p>Institucioni pranon transferime nga të studentëve në vitet ndërmjetëse nga institucionet e tjera të arsimit të lartë , apo njohjen e krediteve të mëparshme, kështu studentit duhet të ndjekë në këtë program jo më pak se 30% të krediteve teorike si dhe diplomën dhe praktikën profesionale. Studenti ka të drejtë të aplikojë për transferim dhe njohje kreditesh vetëm një herë. (Rregulloret UET neni 35, Statuti UET neni 37)</p> <p>Programi i studimit MSH në Infermieri është një program i ri që ka filluar në vitin akademik 2018-2019 dhe nuk është nënshtruar ndryshimeve dhe përmirësimeve. Institucioni deklaron që përfshirja e studentëve në procesin e rishikimit të përmirësimit të programit realizohet me anë të pyetsoreve të studentëve dhe mbledhjeve të hapura të departamentit. <i>GVJ nuk ju vënë në dispozicion pyetsorët përkatës të studentëve të cilët ndjekin këtë program studimi.</i></p> <p><i>GVJ propozon që gjatë fazës së rishikimit të kurrikulës, të përfshihen studentët dhe ku është e mundur të reflektohen sugjerimet dhe propozimet e tyre.</i></p> <p>Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve realizohet sipas një procesi transparent, i cili shprehet në rregulloret e brendshme të institucionit. Provimet realizohen të sekretuara dhe pedagogu organizon seanca sqaruese me qëllim argumentimin e vlerësimit.</p> <p>Studentët gëzojnë të drejtat e tyre të përcaktuara në dokumentat rregullatorë. Të drejtat e studentëve respektohen nga stafi akademik, administrativ, sekretaria dhe drejtuesit e institucionit. Ata kanë të drejtë të njihen me tezën e tyre të provimit, të komentojnë rezultatin dhe të ndjekin të gjitha shkallët e ankimimit</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e</p>	

ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës	për rivlerësim. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Është në filozofinë e institucionit që studentët të vlerësohen drejt dhe të përvehtësojnë sa më shumë dije. (Takimi me stafin, Takimi me studentët).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Bazuar në dokumentacion GVJ evidenton se personeli akademik është aktiv duke marrë pjesë në konferenca dhe kongrese ndërkombëtare, me prezantim oral apo postera. (Cv e stafit akademik). Gjithashtu gjatë vizitë në institucion dhe në RVB ,GVJ evidenton se UET nxit angazhimin e personelit akademik në projekte kërkimore shkencore, konferenca ,publikime duke marrë edhe mbështetje financiare nga institucioni . <i>por GVJ rekomandon shtimin në sasi dhe cilesi të këtyre aktiveve kryesisht të dedikuara në fushën e infermieristikës.</i>
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Cordoba University 2019-2021 dhe është në finalizim marrëveshja me Qëndrën shëndetsore Tirol Austri. Institucioni deklaron që programi MSH në Infermieri është një program i dhe shtimi i projekteve të bashkëpunimit është prioritet i Zyrës së projekteve dhe në aplikimet e ardhshme të thirrjeve ERASMUS –Key Action 1. (Te dhëna mbi projektet, shkëmbimet , publikimet dhe veprimtaria shkencore e stafit akademik ,Ref 43)
Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	Sipas Planit Strategjik 2021-2025 UET synon nxitjen e bashkëpunimeve me institucione të tjera të arsimit të lartë si në Shqipëri ashtu edhe në rajon dhe vendet e BE . Institucion synon gjithashtu organizimin dhe ofrimin e diplomave të përbashkëta me universitetet partnere në fushë specifike.
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	UET ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të huaja të Arsimit të Lartë, me histori suksesi në fushën e kërkimit shkencor, me synimin që të realizojë studime të përbashkëta kërkimore, programe shkëmbimi të studentëve, shkëmbimin e të dhënave kërkimore akademike dhe materialeve teknike, organizimin e veprimtarive të përbashkëta akademike dhe shkencore si konferenca, seminare, simpoziume, etj. (Marrëveshje Bashkëpunimi UET, Ref 34).GVJ sygjeron rritjen e numrit të këtyre marrëveshjeve si me institucione
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	

<p>Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>	<p><i>Brenda ashtu edhe jashtë vendit, duke pasur gjithmonë në konsideratë dhe vlerësimin e efikasitetit të tyre i rekletohet konkretisht në kompetecat që fiton student në fund të studimeve.</i></p> <p>Stafi akademik motivon studentët dhe i fton të marrin pjesë në aktivitete shkencore që zhvillon Universiteti, por nuk ka evidencë për publikime apo botime të studentëve në revista apo buletine shkencore. <i>Sugjerojmë që, një mundësi për të motivuar studentët do të ishte bashkëpunimi dhe publikimi i studimeve apo punimeve të përbashkëta pedagog – student.</i></p> <p>Institucioni akordon cdo vit një fond të vecantë në buxhet për stafin dhe studentët si mbështetje financiare për publikimin e punimeve kërkimore – shkencore në revista shkencore jashtë vendit.</p> <p>Edhe pse programi Master i Shkencave në “Infermieri”, si një program i aplikuar në shkencat mjekësore, synon të angazhojë stafin akademik dhe studentët në rrugën e kërkimit shkencor, nuk ka mundur të përfshihet në studime inovative apo të hapë rrugë drejt patentave.</p> <p>Në funksion të realizimit të diplomës, cdo studentii ofrohet asistencë në modelimin e punimit, mbledhje dhe përpunimit të të dhënave, realizimit të analizave etj. Mqs Institucioni është i paisur me laboratore mesimorë dhe ka marrvshje me Institucione Shëndetësore, <i>sugjerojmë stafin, të shfrytëzojë më mirë kapacitetet institucionale për realizimin e temave të diplomës nga ana e studentëve, vecanërisht në orientimin infermieror të kërkimit shkencor.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

<p>Standardi V.7</p>	
<p>Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>UET ka një lidhur marrvshje apo memorandum bashkëpunimi me 95 IAL kudo në botë, dhe 15 marrvëshje më IAL publike dhe jopublike shqiptare. Institucion synon të kthehen në një pike referimi kombëtare e ndërkombëtare bashkëpunimi universitar dhe kërkimor shkencor duku synuar gjithashtu dhe ofrimin e diplomave të përbashkëta me universitetet partnere.</p> <p>GVJ evidenton se për sa i përket programit të studimit MSH në Infermieri ka mobilitet të stafit akademik në universitetet partnere, por nuk evidenton mobilitet të studentëve. Në takimin me studentet na evidentua që interesi i studenteve të këtij programi për mobilitet është i pakët, pavarësisht mundësive që mund të ofrojë institucioni.</p>
<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje</p>	

të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	Në funksion të këtij programi studimi Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me QSUT, Spitalin e Traumës Spitalin Amerikan dhe Institucine të tjera Shëndetsore Private, në to realizohen praktikat e studentëve dhe ofrohet staf akademik i specializuar. (Evidencë 34: Marrëveshjet)			
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	Stafi akademikështei motivuar të implementojë metoda të kërkimit shkencor, implementim i cili mbështetet edhe në kurrikulën e këtij programi me qëllim që studentët të kenë përgatjen e duhur për vazhdimin e metejshëm të studimeve.			
Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	Megjithatë në takimin me studentët, pyetjes se kush do të vazhdonte studimet në ciklin e tretë nëse i jepej mundësia, iu përgjigj pozitivisht vetëm një student, c'ka regon një motivim të dobët të studentëve për vazhdimësinë e studimeve doktorale. (Takim me studentët).			
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	Parimisht institucioni mirëpret studiues të jashtëm apo pjesëtarë të stafit akademik dhe mbështet projektet ambicioze që vlerësohen pozitivisht. UET merr pjesë si partner në aktivitete të kërkimit shkencor dhe është i hapur për të përdorur infrastrukturën dhe labororet për kërkime. Por, nuk ka evidencë për të dëshmuar thithjen e kërkuesve të huaj apo vendas, pavarësisht vullnetit të mirë. Gjithashtu nuk ka eksperiencë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore, vendas apo të huaj.			
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	UET mbështet mobilitetin e studentëve, pjesëmarrjen e tyre në aktivitete ndërkombëtare si: shkolla verore dhe dimërore, praktika spitalore dhe zhvillimin e moduleve të ndryshme. (Evidencë 43.1: Marrveshje mobiliteteti) Në kuadër të programeve Erasmus + krijohet mundësia e lëvizjes së studentëve dhe stafit. GVJ eidenton se asnjë nga studentët e këtij program studimi nuk ka qenë pjesë e ndonjë progami shkëmbimi apo mobiliteti, pavarësisht se institucioni ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit	Institucioni ka njësi tëposaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, zyra e Kujdesit ndaj Studentit (Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj

të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Studentit)			
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Kjo zyrë ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencën përkatëse për çështje akademike dhe studentore (Dok. Mbi tutoriatin, këshillimin akademik dhe këshillimin metodologjik).</p> <p>Gjithashtu institucioni me anë të këtyre organizmavebën këshillim për përzgjedhjen e programeve të studimit, si edhe orientim për përfshirjen në tregun e punës</p> <p>Informimi, këshillimi, ndjekja e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit realizohet nga Zyra e kujdesit nga Studenti, Zyra e Karrierës dhe Sekretaria Mësimore. Informacioni dhe orientimi e studentëve në lidhje me procesin mësimor, orientimin për praktikën profesionalerealizohet kryesisht në nivel departamente nga kordinatorja e programit.</p> <p>Zyra e Kujdesit ndaj Studentit dhe Zyra e Keshillimit te Karrieres, ndjekecurinë estudimevetëstudentit, që ngamomenti i regjistrimit,derinë diplomimin e tij, në këtë program studimi ka vetëm një student të diplomuar,i cili ështëipunësuar, në këto kushte , GVJ nuk mund të vlerësojë aktivitetin konkret të Zyrës së karrierës në lidhje me këtë program studimi.</p> <p>Gjatë takimit më studentin u deklarua personeli akademik luan një rol të rëndësishëm si në këshillim akademik ashtu edhe këshillim karriere.</p> <p>Gjatë takimi me perfaqesuesit e zyrës dhe nëRVB theksohet se instucioni ka ngritur dhe ka funksional rrjetin ALUMNIstudentet pjesëmarrës përfshihen në bordet e tregut të punës pranë departamenteve, porende nuk ka student të diplomuar në këtë program të cilët të jënë pjesë e ketij rrjeti.</p> <p>Sic u tha me lart GVJ nuk mund të vlerësojekriterin 4 pasi ky është një program I ri , vetëm më një student të diplomuar.</p>			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.				
Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UETka përpunuar dhe zbaton politika dhe ka ndërtuar stuktura dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Bazuar në Nenin 103 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë: “Institucionet e Arsimit të Lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë”. Struktura dhe funksionimi i Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) përcaktohen në Statutin e Institucionit të Arsimit të Lartë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka të sanksionuar në Statutin e vet përgjigjësitë institucionale për sigurimin e cilësisë në nivel institucional, të programeve të studimit, aspekteve të mësimdhënies etj. Këto politika përcaktohen në nenin 11 të këtij statut, rregulloren e UET dhe Dokumentin f.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, këto politika janë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore.</p> <p>Institucioni ka ngritur dhe ka funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. IAL, bazuar në Nenin 16 të Statutit ka ngritur Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë i cili funksionon si një strukturë autonome dhe e përhershme pranë institucionit. Ky komision ka funksionuar në fillim në formë të grupeve ad hoc dhe në vazhdimësi nga viti 2011 në formë të një njësie të përherëshme në strukturën e Institucionit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Njësia ka rregulloren mbi të cilën bazon aktivitetin e saj dhe vlerëson në mënyrë periodike aktivitetin mësimor dhe kërkimor shkencor të institucionit.</p> <p>Në përbërje të KSBC janë 9 persona personel akademik, ku përfshihen përfaqësues të Fakulteteve një personel ndihmës akademik/administrativ dhe një ekspert i jashtëm, gjithashtu në përbërje të KSBC janë dhe një përfaqësues të studentëve (Ref.Nr.30, Tabela 24 Aneks) :</p> <p>Në detyrat e KSBC përfshihet vlerësimi i rezultateve të veprimtarive mesimore, kërkimore shkencore duke propozuar hendryshime të nevojshme në funksion përmirësimin evazhdueshëm të cilësisë. (Neni 16, Statuti i UET , takim me përfaqësues të zyrës.)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës</p>	<p>Përveç kësaj stukture institucionale ngritur Zyrën e Standarteve dhe të cilësisë e cila përpunon politikat dhe strategjitë në funksion të rritjes së cilësisë.</p> <p>Institucioni ka dhe përdor instrumenta për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. UET i nënshtrohet vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues institucional gjithashtu dhe të programeve të studimit në përputhje</p>

<p>së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Njësia e sigurimit të brendshëm, deklaron se bën vlerësim periodik të veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore të Universitetit dhe harton Raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm të cilat diskutohen në të gjitha njësitë e UET (Neni 16, Statuti i UET, takim me përfaqësues të zyrës.). Ajo e bazon veprimtarinë e saj në dokumenta konkrete (Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, Ref 30.3) dhe përpilon një plan kalendarik veprimi.</p> <p>Kjo njësi periodikisht informon drejtuesit e njësive, në lidhje me rezultatet e monitorimeve më qëllim rëfleksiv dhe përmirësimin e problematikave.</p> <p><i>GVJ pas verifikimit në të cilën nuk gjeti Raporte Vjetore të Institucionit të viteve të fundit dhe raport vlerësimi të apo analiza dhe vlerësime konkrete të realizuar nga KSBC për programin në fjalë.</i></p> <p>KSBS funksionon në bazë të një programi të hollësishëm pune i cili përfshin gjithë institucionin por nuk ka aktivitet konkret me anë të grupeve ad-hoc në nivel njësie kryesore apo njësie baze.</p> <p><i>Analiza vjetore e programit ka të dhëna sasore por nuk bën analizë apo adresim të problematikave.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni ka ngritur dhe ka funksionale njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të ciklit të dytë të studimeve. Njësia përgjegjëse për kryerjen e këtij funksioni është Zyrë e Zhvillimit të Kurrikulave (Statuti UET, Neni 30).</p> <p>Njëkohësisht në përmbushjen e këtyre qëllimeve një rol të rëndësishëm kanë departamentet koorordinatorë të programeve realizojnë funksione specifike në lidhje me rishikimin dhe përmirësimin e programeve duke u bazuar gjithmonë në parashikimet ligjore dhe në strategjinë e sigurimit të cilësisë së UET (Ref nr 30.3)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit</p>	<p>Departamenti përgjegjës i programit ka realizuar një analizë vjetore të këtij programi studimi ku janë përfshirë informacione në lidhje me kurrikulën dhe</p>

të studimit të ciklit të dytë.	personeline angazhuar në program, përditësimi e literaturës, rezultatet e studenteve(vetëm kalueshmëria). <i>Por më tejGVJ nuk ka evidentuar procese konkrete të dokumentuaratë mbikqyrjes, rishqyrtimit rishikimit më qëllim përmirësiminnë këtë program studimi.</i>			
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	UET përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e herë pas hershme të programit të studimit. Vetëvlerësimi është një proces sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave sasiore dhe cilësore nga burime të ndryshme, me qëllim përmirësimin e mësimnxënjes së studentëve dhe vlerësimin e përmbushjes së standarteve akademike.			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	UAL përdor metodologji vlerësimi, instrumentat matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbajtjen e programit të studimit si Treguesit e performancës akademike apo pyetësorin e studentëve. (Ref 40, 40.1, 41.Formatet evlerësimit,vetëvlerësimit,ankesave etj).			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Rezultatet e aktiviteteve me karakter vlerësues dhe monitorues dokumentohen dhe raportohen pranë rektoratit dhe njësisive kryesore,njëkohësisht KSBC adreson mangësi dhe rekomandon detyra me qëllim përmirësimin e cilësisë. <i>GVJ rekomandon rritje e efincencës në analizimin e informacionit dhe të dhënave,në përpilimine rekomandimeve më të detajuara dhe një plani punë me adresim konkret të problematikave.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme	Bazuar në dokumentet e UET dhenga informacioni i marrë, rezulton seKSBC bën vlerësim institucional dhe harton raporte për të gjithë programet e studimit,ndërsa vlerësimi i programeve specifikekryhetnga departamentet duke u përfshirë më tej në akreditimin insticional dhe të programeve. Kështu GVJ nuk evidentoi raporte periodike të vlërësimit të këtij program studimi, GVJ thekson se analiza vjetore e programit ka të dhëna sasiore por nuk bën analizë apo adresim të problematikave. Për kryerjen e vlerësimit Institucionipërdor metodat dhe instrumente të ndryshme të drejtpërdrejta sic janë: monitorimin i mësimdhënies, <i>vlerësim të</i>

<p>periodike.</p>	<p><i>cilësisë së mësimdhënies</i> , vlerësimi i kurrikulës , monitorimi i provimeve, dëgjime në auditor, vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve, praktikës etj, metoda vlerësimi të cilat u deklaruan se zhvillohen në mënyrë periodike [takimi me drejtuesit].</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Gjithashtu edhe në planin vjetor të punës janë parashikuar aktivitete në lidhje me vlerësimin e kurrikulave, vlerësimin e mesimdhënies, vlerësimin e punës kerkimore shkencore etj. [plani i punës KSBC].</p> <p><i>GVJ nuk eidentoi vlerësim të programit të studimit përmestestimeve lokale apo të standardizuara, testime ndër institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara pasi programi është në vitin e parë të realizimit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Instrucioni ,gjithashtu përdor dhe instrumenta të tëthorta vlerësimi sic janë ; sondazhe të studentëve , të personelit akademik, ndihmës akademik apo të institucioneve të cilat bashkëpunojnë për programin e studimit , intervista etj.Rezultatet e këtyre vlerësimeveraportohen tek drejtuesit e departamente dhe dekanëve, duke u bërë pjesë e vlerësimit të performancës të cdo pedagogu në fund të vitit akademik.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u deklarua ashtu sic dhe eidentohet në RVB,që gjatë zhvillimit të mësimin onlinepërmes platformave UET LMS dhe microsoft teams,më vendim Senati monitorimi i procesit mësimor është mundësuar na zyra IT e UET. Cilësia dhe metodologjia janë vlerësuar dhe monitoruar nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Theksojmë që aktorët e jashtëm japin një kontribut mjaft pozitiv në realizimin e praktikave mësimore e profesionale <i>pormungon kontributi ityre konkretnevlerësimin erealizimit dhecilësisë së programit të studimit në funksiontë përmirësimit të cilësisë së tij.</i></p> <p>Programi ende nuk e ka formuar rrjetin e tij Alumni, pasi nuk janë diplomuar ende studentet e parë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve</p>	

e kompetencave të përftuara nga ky program				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni, nëpërmjet akteve të tij si statut, rregullore, garanton përfshirjen e studentëve dhe personelit akademik si aktor të brendshëm në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë, për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Komisioni përbëhet përbëhet nga Kryetari i Komisionit, 9 persona personel akademik , ku përfshihen përfaqësues të Fakulteteve një personel ndihmës akademik/administrativ dhe një ekspert i jashtëm , gjithashtu në përberje të KSBC janë dhe një përfaqësues të studentëve (Ref .Nr.30, Tabela 24 Aneks) :
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Gjithashtu pranë departamenteve janë ndritur Bordete Tregut të punës si organe këshilluese në funksion të rritjes së cilësisë. Anëtarët përbërës të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë, kanë përgjegjësi dhe detyra konkrete dhe të ndryshme, më qëllim garantimin e cilësisë së programeve të studimit. Përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit është garantuar nga statuti i institucionit dhe rregullorja e KCBC.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit përqipët të shmange çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve të përcaktuara sipas Nenit 42 mbi Të drejtat e Studentëve (rregullore e UET) dukerespektuar integritetin akademik dhe shmangjen e diskriminimit apo pabarazisë.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik	UET është i përfshirë gjithashtu në dy projekte europiane të cilat kanë në fokus sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë. : projekti TEMPUS “ENCHASE” dhe ERASMUS + QainAL, projekte të cilat kanë një rol të rëndësishëm në shkëmbimin e përvojave , realizimin e

dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	trajtimeve, përmirësimin e metodologjive monitoruese dhe vlerësuese.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	UETka eksperiencë pozitive në angazhimin e personave të kualifikuar dhe profesionistëve si pjesë e personelit akademik me kontratë. Në këtë drejtim kontributi i tyre është idukshëm në ofrimin e programit. <i>Mendojmë që angazhimi i bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj duhet të rritet dhe të tërëtojë efektet konkrete në përmirësimin e tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në faqen zyrtare të institucionit janë publikuar mjaft informacione që informojnë publikun dhe studentët e rinj. Dokumentet kryesore janë publike dhe të aksesueshme në faqen e internetit. Ndërkohë informacionet në lidhje me veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për institucionin në tërësi janë të pakta, (vërtet disa raporte vlerësimi të viteve të shkuara në disa programe studimi)[faqja e internetit UET]. <i>GVJ konstaton që informacionet në lidhje me rezultatin e vlerësimit të programit të studimit mungojnë.</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimin të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ nuk evidentoi raste të thyerjes së lirisë akademike apo shkelje të legjislacionit për të dhënat personale. Në RVBdeklarohet se në rast se në raporte e vlerësimit ka të dhëna me sensibilitete të lartë rastet trajtohen nga drejtuesit në takime private. GVJ theksoi më lart se në raportimet që janë kryer nga IAL janë raporte përshkruese jo analitike. Këto raporte nuk shoqërohen me plane masashapo adresim problematike të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. Prandaj <i>GVJ rithekson që në kuadër të përmirësimit të treguesve të cilësisë, institucioni duhet të zhvillojë më tej mekanizmat</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e	

dobësive të evidentuara.	<i>analitikë të evidentimit të performancës në nivel institucional dhe adresimit të problematikave në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	KSBC ka një plan punë të detajuar të aktivitetit të saj,dhe GVJ vlerëson se stafi akademik dhe studentët janë të përfshirë në sigurimine brendëshëm të cilesisë kryesisht në metodat e tërthorta të përdorura nga KSBC,pjesëmarrjës së studentëve në struktura institucionale,javës së orientimit etj, <i>por GVJrekomandon shtimin dhe rritjen e eficenses se aktivite me personelin dhe studentët ,me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit Master i Shkencave në “Infermieri” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Kurrikula e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Infermieri” është hartuar bazuar në modelet më të mira kombëtare dhe evropiane, duke respektuar standardet dhe kornizën ligjore në fuqi.
2. Infrastruktura fizike, logjistika në funksion të programit të studimit dhe mësimdhënia me metoda bashkëkohore të cilat ndikojnë në përfitim të aftësisve dhe kompetencave profesionale në fushën e kujdesit shëndetësor.
3. Praktika e zhvillimi të panairit të punës, bashkëpunimi me përfaqësues të tregut të punës dhe përfshirja e tyre në procesin e rishikimit të programeve të studimit, apo në mësimdhënie për tema specifike të ekspertizës së tyre profesionale, e cila ndihmon që programi t’i përgjigjet më mirë kërkesave të tregut të punës dhe punësimin e studentëve pas diplomimit.

Pika të dobta

1. Numri jo i mjaftueshëm i pedagogëve të kategorisë profesor.
2. Mos përputhje të formimit profesional dhe ekspertizës së pedagogut me lëndët që zhvillojnë në program. Psh pedagog me formim biologji zhvillojnë lëndë mjekësore si mjekësi laboratorike, mikrobiologji, biokimi mjekësore.
3. Punësimi i pedagogëve me kohë të plotë në dy institucione njëkohësisht ndikon që pedagogu të mos jetë present gjatë gjithë kohës në fakultet.
4. Literatura e pakët në gjuhën shqipe për programet e studimit në fushën e infermierisë.



Rekomandime

1. Rishikimi i titullarëve të lëndëve dhe emërimin titullar lënde të pedagogëve të kategorisë profesor për të gjitha lëndët. Formimi profesional dhe ekspertiza që ofron pedagogu të përputhen me lëndën që ai zhvillon në programin e studimit.
2. Rishpërndarje të krediteve në këtë program studimi midis lëndëve karakterizuese duke i dhënë prioritet lëndëve të profilit infermieror.
3. Rekrutimi i personelit ndihmës akademik në program për realizimin e orëve laboratorike klinike dhe praktikave mësimore.


Conclusions of the study program evaluation o the second cycle study Scientific Master in “Nursing” in Higher Education Institution“ European University of Tirana”.

Strengths points

1. Curriculum of the study program of the second cycle “Scientific Master in Nursing” is designed based on the best national and European models, respecting the standards and legal framework in power.
2. Physical infrastructure and logistics in function of the study program and teaching with modern methods which affect to the acquisition of professional skills and competencies in the field of health care.
3. The practice of developing a job fair, cooperating with labor market representatives and involving them in the process of reviewing study programs, or developed open lectures in specific topics of their professional expertise, which helps the program to better responds to labor market demands and student employment after graduation.

Weak points:



1. Insufficient number of academic staff from the category of professor.
2. Non-compliance of the professional training and expertise of the lecturer with the syllabus/courses developed in the program. For example, lecturer with biology training develop medical curricula such as laboratory medicine, medical microbiology and medical biochemistry.



3. The employment of full-time of academic staff in two institutions at the same time affects the lecturer not to be present at all times in the faculty.
4. Little literature in Albanian language for study programs in the field of nursing.

Recommendations:

1. Review of course holders and appointment "course holders" the academic staff of the professor category.
2. To review the distribution of the ETC in this study program among specifying syllabus/curriclesgiving priority to the syllabus/curricules of the nursing profile.
3. Recruitment of technical staff/academic support staff in the program for the realization of clinical laboratory hours and teaching practices in laboratory that support teaching and learning



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X